

*Doracak për bashkëpunëtorët profesional*

**P Ë R K R A H J A  
N X Ë N Ë S V E M E  
V Ë S H T I R Ë S I  
N Ë M Ë S I M**



BYRO PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
REPUBLIKA E MAQEDONISË



**PROGRAMI:**

**ARSIMI INKLUZIV NË SHKOLLAT FILLORE**

# **PËRKRAHJA NXËNËSVE ME VËSHTIRËSI NË MËSIM**

**Doracak për bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore**

**Shkup, 2017**

## **Botues** **BYRO PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

### **Autorë**

Andrijana Tasevska  
m-r Gorica Mickovska

### **Bashkëpunëtorë**

m-r Anica Aleksova  
m-r Rozalija Boshkovski  
Ubavka Butleska  
d-r Anica Zllatevska

### **Përkthimi:**

Катица Трајкова

### **Dizajn:**

Brigada

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

159.953-057.874-056.36(035)

ТАСЕВСКА, Андријана

Поддршка на учениците со потешкотии во учењето : прирачник за стручни соработници во основните училишта / [автори Андријана Тасевска, Горица Мицковска].

- Скопје : Биро за развој на образованието, 2018. - 64 стр. : илустр. ; 20 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 64

ISBN 978-608-206-059-0

1. Мицковска, Горица [автор]

а) Потешкотии во учењето - Поддршка на ученици - Прирачници

COBISS.MK-ID 105909258

Qëndrimet e dhëna në këtë doracak janë të autorëve dhe nuk do të thotë se përshtaten me qëndrimet dhe politikat e UNICEF-it.

Botimi është përgatitur me përkrahje të Zyrës së UNICEF-it në Shkup dhe Qendrës maqedonase për arsim qytetar.

Autorët ju falenderohen bashkëpunëtorëve profesional të njëzet shkollave fillore të cilët në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2016/2017 i zbatuan procedurat dhe instrumentet e propozuara për t'ju zvogëluar vështirësitë dhe të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi të caktuara të nxënësve të cilët kanë nevojë nga përkrahjet specifike. Informata këthyese nga bashkëpunëtorët profesional mundësuan që të përgatitet versioni final i këtij doracaku.

Shkollat të cilat bashkëpunëtorët profesional janë trajnuar për përkrahje të nxënësve me vështirësi në mësimnxënie janë:

“11 Tetori”, Kumanovë  
“Aleksandar Zdravkovski”, Jegunovcë  
“Vëllezërit Ramiz dhe Hamid”, Shuto Orizarë  
“Vasil Gllavinov”, Veles  
“Vidoe Podgorec”, Strumicë  
“Goce Dellçev”, Prilep  
“Dane Krapçev”, Shkup  
“Dimitar Vllahov”, Shtip  
“Dimo Haxhi Dimov”, Shkup  
“Dobre Jovanovski”, Prilep  
“Gjorgji Sugarev”, Manastir  
“Gjorgjija Pulevski”, Shkup  
“Edinstvo – Bashkimi – Birlik”, Gostivar  
“Krume Kepeski”, Shkup  
“Kole Kaninski”, Manastir  
“Lazo Angelovski”, Shkup  
“Luben Llape”, Shkup  
“Malina Popivanov”, Koçan  
“Mustafa Kemal Atatürk”, Gostivar  
“Naim Frashëri”, Tetovë  
“Shën Kirili dhe Metodi”, Makedonska Kamenicë



# PËRMBAJTJE

Hyrje.....	7
<b>Pjesa e parë: Vështirësitë në mësimnxënie, llojet e çrregullimeve dhe faktorët të cilët ndikojnë në procesin mësimor dhe sjelljen e nxënësve.....</b>	<b>9</b>
1. Vështirësitë e përgjithshme në procesin e mësimnxënies .....	11
2. Vështirësitë e mësimnxënies të shkaktuara nga deprivimi social, ekonomik dhe kulturor .....	12
3. Vështirësitë specifike në procesin e mësimnxënies .....	13
3.1. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga mungesa e vëmendjes / çrregullimi hiperaktiv.....	14
3.2. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga çrregullimi i procesit të leximit - Disleksioni.....	16
3.3. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga çrregullimi i procesit të shkruarit - Disgrafia.....	19
3.4. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga çrregullimi në procesin e nxjerrjes së operacioneve matematikore - Diskalkulia.....	22
3.5. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga aftësitë e zvogëluara intelektuale	24
<b>Pjesa e dytë: Identifikimi i vështirësive, planifikimi dhe evidentimi i përkrahjes individuale... 27</b>	<b>27</b>
1. Identifikimi dhe vlerësimi fillestar .....	28
2. Planifikimi .....	29
2.1. Modeli i Planit për ekipin e bashkëpunëtorëve profesional për përkrahje individuale nxënësve me vështirësi në mësimnxënie .....	29
2.2. Modeli i Planit të bashkëpunëtorit profesional për përkrahje individuale të nxënësve me vështirësi në mësimnxënie .....	30
3. Evidenca.....	31
3.1. Modeli i Formularit për evidencën e përkrahjes së realizuar individuale .....	31
3.2. Modeli i Formularit për evidencë të ushtrimeve të realizuara për memorim .....	32
<b>Pjesa e tretë: Strategji, mënyra dhe shembuj të materialeve për përkrahje individuale..... 33</b>	<b>33</b>
3.1. Emocione dhe raporte sociale .....	34
3.2. Vëmendja dhe koncentrimi.....	45
3.3. Perceptimi dhe të mbajturit mend.....	49
3.4. Motorika.....	57
3.5. Aktivitete tjera për nxitjen dhe zhvillimin e të folurit, aftësive gjuhësore dhe matematikore .....	64
<b>Letërsia dhe burimet.....</b>	<b>66</b>





Të gjithë fëmijët janë të ndryshëm, por të gjithë kanë të drejta të njejta në arsim, pa marrë parasyshë prejardhjen ose aftësitë e tyre. Për të gjithë ata duhet të jemi dora për të cilën do të mbështeten kur do ta kenë vështirë dhe buzëqeshja e cila do ti motivon të vazhdojnë më tutje, për shkak se besojnë se secili fëmijë mundet ti shfrytëzon të gjitha potencialet e veta në rast se ka përkrahje përkatëse. Nxënësit nuk do ti vlerësojmë sipas asaj që nuk e kanë ose që bëjnë ndryshe nga të priturat e zakonshme, por sipas asaj që e kanë dhe që i bën të jenë të vetmit.

Sipas Kompetencave dhe standardeve themelore profesionale për bashkëpunëtorë profesional në shkolla<sup>1</sup>, në pjesën, Vlerat profesionale/më e rëndësishme është nxënësi: “bashkëpunëtorët profesional janë përkushtuar të punojnë në interes të nxënësve dhe në plan të parë e vëndojnë mësimnxënien e tyre, sjelljen dhe shëndetin mental. Ata besojnë se puna e tyre në shkollë mund të kontribuojë maksimalisht që të zhvillohen potencialet e nxënësve dhe punojnë me përkushtim në arritjen e këtij qëllimi”. Në dokumentin e njejtë, në pjesën Kompetencat e përbahkëta të bashkëpunëtorëve profesional – puna me nxënës është përmendur se: “Bashkëpunëtorët profesional kompetent dijnë se si mësojnë fëmijët dhe si zhvillohen dhe ju japin përkrahje të gjithë nxënësve. Ata dijnë se secili fëmijë mund të arrijë maksimumin e vetë nëse i jepet mundësi përkatëse. Ata ndërmarrin aktivitete përkatëse për kyçjen e të gjithë fëmijëve në procesin arsimor dhe në përfshirjen adekuate të tyre në kontekstin shkollor. Ata i trajtojnë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, por i identifikojnë dallimet e tyre individuale dhe i marrin parasyshë në punën e tyre me ta. Gjatë kësaj bashkëpunëtorët profesional e bazojnë punën e tyre ndaj observimit në kontinuitet dhe vlerësimin për interesin më të mirë të nxënësve, si dhe vlerësimin në kontinuitet të diturive të tyre, potencialeve të tyre, anëve të forta, shkathtësive dhe rrethit familjar. Bashkëpunëtorët profesional kanë dituri dhe shkathtësi për punë individuale dhe grupe me nxënësit me qëllim që të nxitet dhe përkrahet zhvillimi intelektual dhe socio-emocional i nxënësit, dituria dhe përparimi i tij.”<sup>2</sup> Nga kjo del se, bashkëpunëtorët profesional janë kompetent të punojnë në identifikimin dhe nxitjen e potencialeve të nxënësve, veçanërisht të atyre të cilët kanë vështirësi në mësim dhe të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të cilët do t’ju mundësojnë përparim, gjegjësisht të ndikojnë që këta fëmijë të jenë të përgatitur për mësimnxënie dhe funksionim jetësor. Përveç se ju japin këshilla dhe udhëzime arsimatrive dhe prindërve për punë me fëmijë që ballafaqohen me vështirësi në mësimnxënie, bashkëpunëtorët profesional, në shumë raste duhet të japin përkrahje intervenuese ose më afatgjate individuale/direkte<sup>3</sup> përkrahje disave nga këta fëmijë. Ligji për Arsim fillor<sup>4</sup> në nenin 85-a, alinea 2 gjithashtu përcakton fushat e kompetencave profesionale të bashkëpunëtorëve profesional, ndërmjet të cilave në mënyrë eksplicite është caktuar fusha – puna me nxënës.

1 <http://bro.gov.mk/docs/USAID/MKD/02%20snovni%20profesionalni%20kompetencii%20i%20standardi%20za%20strucni%20sorabotnici.pdf>

2 Më shumë për kompetencat themelore profesionale në linkun vijues: <http://bro.gov.mk/docs/USAID/MKD/02%20snovni%20profesionalni%20kompetencii%20i%20standardi%20za%20strucni%20sorabotnici.pdf>

3 Në Doracak do të hasen termet përkrahje individuale, përkrahje jondërmjetësuese/direkte, në kuptim se bashkëpunëtorët profesional punon me nxënësin në mënyrë individuale dhe përkrahjen të cila i’a jep është e jondërmjetësuese/direkte. Përkrahjen të cilën ia japin bashkëpunëtorët profesional nxënësit nëpërmjet arsimtarit është indirekte/ndërmjetësuese.

4 <http://www.sonk.org.mk/documents/Zakon%20za%20osnovno%20obrazovanie.pdf>, „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015 dhe 30/2016

Ky doracak është paramenduar si pikë fillestare për bashkëpunëtorët profesional nëpër shkolla për gjetjen e mënyrave dhe dhënies së përkrahjes direkte individuale nxënësve me vështirësi në mësim, veçanërisht nxënësve të cilët ju takojnë grupeve të margjinalizuara. Doracaku do t'ju ndihmojë bashkëpunëtorëve profesional edhe në dhënien e këshillave dhe përkrahjes arsimtarëve gjatë mësimdhënies së nxënësve me vështirësi në mësim. Në te nuk ka ndarje të kompetencave/intervenimeve në profile të ndryshme të bashkëpunëtorëve profesional (psikolog, pedagog, defektolog – edukator special dhe rehabilitues), por duke u nisur nga paramendimi se bashkëpunëtorët profesional duhet të veprojnë në mënyrë ekipore/të koordinuar/ për ineters më të mirë të fëmijës, janë përshkruar qasje dhe intervenime si dhe materiale për punë me nxënësit. Secili bashkëpunëtor profesional duhet ti zgjedh vetë ose në marrëveshje me kolegët, ata qasje për të cilat ndjehet kompetent dhe mendon se mundet në mënyrë të suksesshme ti zbatojë.

Në këtë doracak do të bëhet fjalë për punën me fëmijë të cilët vështirësitë në mësimnxënie mund të paraqiten si pasojë e llojeve të ndryshme të pengesave si dhe si pasojë e ndikimeve të caktuara jo të përshtatshme socio - kulturore.

Në pjesën e parë të Doracakut shkurtimisht janë përshkruar disa pengesa të cilat shkaktojnë vështirësi në mësimnxënie dhe faktorë të cilët ndikojnë në mënyrë jo të përshtatshme në procesin e mësimnxënies dhe sjelljes të nxënësit nga mjediset e deprivuara sociale dhe kulturore dhe të cilat më së shpeshti hasen në shkollat tona<sup>5</sup>. Qëllimi i kësaj pjese është të tregojë për vështirësitë specifike në fushat kyçe: vëmendja dhe koncentrimi, perceptimi, të mbajturit mend, motorika, emocionet dhe raportet sociale dhe funksionet kognitive. Te vështirësitë në fushat e përmendura bashkëpunëtorët profesional mund të intervenojnë nëpërmjet të përkrahjes së përafërt dhe të ndihmojnë në tejkalimin ose në zvogëlimin e llojit konkret të vështirësisë.

Në pjesën e dytë të Doracakut është përshkruar mënyra se si mund të caktohet fusha/fushat në të cilën/cilat paraqiten vështirësi dhe mënyrat se si planifikohet përkrahja e menjëhershme e nxënësve. Në Doracak janë kyçur disa protokole/formulare të cilët mundësojnë të evidentohen aktivitetet lidhur me procesin e identifikimit të vështirësive, procesit të planifikimit të përkrahjes individuale dhe procesit të punës direkte me nxënësin.

Në pjesën e tretë të Doracakut janë dhënë përshkrime për llojin e vështirësisë në korniza të disa fushave të intervenimit, si dhe shembuj të procedurave dhe materialeve nëpërmjet të së cilave bashkëpunëtorët profesional në rrugë të intervenimit direkt mund ti zvogëlojnë vështirësitë, të zhvillojnë aftësi të caktuara dhe shkathtësi të nxënësi dhe ta përgatitin për procesin e mësimnxënies, me çka përveç që ndihmojnë nxënësin, ndërmjetësisht i ndihmojnë edhe arsimtarin.

Të gjitha vështirësitë në mësimnxënie nuk janë të karakterit të njejtë. Bile edhe atëherë kur punohet për ndonjë grup/sindrom të caktuar të pengesave ose grupi të faktorëve sociologjik të cilët shkaktojnë vështirësi në mësimnxënie, nuk duhet të presim se manifestimi i tyre te fëmijët do të zhvillohet në mënyrë identike dhe se do të ekzistojë procedurë e vetme ose formulë me të cilën vështirësia do të tejkalohet. Për këtë shkak, flaism për përkrahje individuale, në të cilën do të vijnë në shprehje shkathtësitë dhe sensibiliteti i bashkëpunëtorit profesional për ti zgjedhur strategjitë e ofruara të përshtatshme, aktivitetet dhe materialet për secilin nxënësi në veçanti.

Doracaku ju është përkushtuar bashkëpunëtorëve profesional me më pak përvojë për t'ju ndihmuar që më mirë ta planifikojnë dhe realizojnë punën me nxënësi me vështirësi në mësimnxënie, por edhe për ata me më tepër përvojë ti kontrollojnë dhe pasurojnë qasjet e tyre që i shfrytëzojnë gjatë përkrahjes së këtyre nxënësve. Doracakun mundet ta shfrytëzojnë edhe arsimtarët për ti pasuruar strategjitë për mësimnxënie gjatë punës me nxënësit me vështirësi në mësimnxënie.

5 Sygjerohet bashkëpunëtorët profesional që më gjërësisht të njihen me karakteristikat e pengesave dhe faktorët të cilët shkaktojnë vështirësi në mësimnxënie.

**PJESA E PARË:****VËSHIRËSITË NË MËSIMNXËNIE,  
LLOJET E ÇRREGULLIMEVE DHE FAKTORËT TË CILËT  
NDIKOJNË NË PROCESIN MËSIMOR DHE SJELLJEN  
E NXËNËSVE**

**V**ështirësitë në mësimnxënie mundet të jenë nga të lehta dhe afatshkurte, deri te të vështirat me afatgjatë tërë jetës. Ata nuk mund të identifikohen deri sa fëmija nuk nisët për në shkollë, gjegjësisht deri sa nga ai nuk fillohet që të priten të kryhen detyra specifike akademike, të cilat në realitet do të tregojnë vështirësitë në fushën e proceseve kognitive. Rezultatet e vështirësive në mësimnxënie janë të arritura të papritura të ulëta, ndërsa mënyra se si manifestohen vështirësitë mund të ndryshojnë gjatë jetës së personit, varësisht nga kërkesat e mjedisit nga njëra anë dhe mundësitë dhe nevojat e personit nga ana tjetër.

Sipas Learning Disabilities Association of Canada dhe the BC Association of School Psychologists „vështirësitë në mësimnxënie kanë të bëjnë me numër të madh të gjendjeve të cilat mund të ndikojnë në procesin e pranimit, organizimit, mbajtjes, të kuptuarit dhe zbatimit të informatave verbale dhe jo-verbale. Çrregullimet e këtyre proceseve ndikojnë në mundësinë për mësimnxënie dhe manifestohen nëpërmjet mundësive të domosdoshme mesatare dhe të ulëta për mendim dhe sjellje të përfundimeve.

Në këtë mënyrë, vështirësitë në mësimnxënie mund ti shqyrtojmë pavarësisht nga vështirësitë inetelektuale të përgjithshme. Vështirësitë në mësimnxënie paraqiten si rezultat i çrregullimit ose zvogëlimit të funksionalitetit të një ose më tepër proceseve lidhur me perceptimin, të mbajturit mend dhe mendimin. Këtu janë të kyçura, por jo gjithmonë edhe proceset e të folurit, aftësive gjuhësore, procesit vizuel, procesit të shpejtësisë, vëmendjes, koncentrimit dhe funksioneve mendore më të zgjeruara siç janë planifikimi dhe sjellja e vendimeve.

Vështirësitë në mësimnxënie dallohen sipas intensitetit dhe mundet ta pengojnë formimin dhe përdorimin e:

- Biseda (dëgjimi, të folurit, të kuptuarit)
- Të lexuarit (dekodimi, fonetika, njohja e fjalëve, të kuptuarit)
- Të shkruarit
- Matematika (njejsimi, zgjidhja e problemeve).

Vështirësitë në mësimnxënie mundet të kyçin edhe vështirësi në aftësitë organizative, perceptimet sociale, interaksionin social dhe marrjen e aksionit.“<sup>6</sup>

Në anën tjetër, vështirësitë në mësimnxënie mund të dalin nga pengesa të ndryshme të cilat paraqiten në fushat e vëmendjes, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, aftësive matematikore dhe aftësive të përgjithshme intelektuale.

Për këtë shkak për fëmijët me vështirësi në mësimnxënie duhet të kemi lloje të ndryshme të ndihmave në mësimnxënie, por, për ta përshtatur përkrahjen të cilën do t’ju a japim secilit nxënës, është e domosdoshme ti njohim shkaqet të cilat e shaktojnë vështirësinë dhe karakteristikat e manifestimit të vështirësisë.

6 Supporting Students with Learning Disabilities, A Guide for Teachers , Ministry of Education and the British Columbia School Superintendent’s Association, 2011

Fëmijët me **vështirësi të përgjithëshme në mësimnxënie**, kanë zhvillim më të ngadalshëm në aftësitë e përgjithëshme kognitive, mësojnë më ngadalë dhe kanë të arritura më të ulëta në pjesën më të madhe të lëndëve mësimore, gjegjësisht kanë nevojë për më tepër kohë për përvetësimin e materilait mësimor, i arrijnë vetëm qëllimet më të ulëta mësimore, por përsëri përparojnë.

Një përqindje e caktuar e fëmijëve **për shkak të deprivimit social, ekonomik dhe kulturor** nuk i kanë mundësitë e nevojshme dhe nxitjen në fushën kognitive, sociale, emocionale dhe motivuese, dhe për këte tregojnë interes më të vogël për mësimnxënie, përshtatje më të ulët në mjedisin shkollor që rezulton edhe me rezultate më të dobëta.

Fëmijët të cilët kanë **vështirësi specifike në mësimnxënie** janë më pak të suksesshëm ose më pak të suksesshëm gjatë përmirësimit të diturive dhe shkathtësive në fusha të caktuara të mësimnxënies, (lexim, shkrim, matematikë). Këta janë nxënës të cilët paraqiten probleme në zhvillimin e hershëm dhe kanë vështirësi më të shprehura lidhur me vëmendjen të mbajturit mend, të menduarit, koordinimin, komunikimin, leximin, shkrimin, matematikën, por edhe me zhvillimin e shkathtësive sociale dhe pjekurinë emocionale. Këta fëmijë më së shpeshti kanë probleme me pranimin, përpunimin dhe riprodhimin e informatave.

Te të gjitha këta grupe të nxënësve mundet në një periudhë më të shkurtë ose më të gjatë të paraqiten probleme në sjellje që ndikojnë edhe në mësimnxënien e tyre.

Vështirësitë në mësimnxënie mundet të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm. Ata mund të grupohen si:

**Të brendshme** – aftësi të ulëta intelektuale, pengesa të ndryshme në fushën e perceptimeve, përshtatje socio-emotive, pengesave fiziologjike, zhvillimi më i dobët i aftësive për vetë rregullim, etj.

**Të jashtme** – kufizime sociale dhe/ose kulturore – njohje jo e mjaftueshme e gjuhës, kujdesi jopërkatës dhe mungesa e interesit për përkrahje dhe mësimnxënie, marginalizimi, mjedisi jostimulativ, vobektësia, etj.

Në këtë pjesë do të japim pasqyrë të asaj se si llojet më të shpeshta të pengesave dhe faktorët që i takojmë në shkolla ndikojnë ndaj fushave të caktuara të zhvillimit, me ate edhe ndaj procesit të mësimnxënies.

## 1 | VËSHIRËSITË E PËRGJITHSHME NË PROCESIN E MËSIMNXËNIES

Secili fëmijë gjatë arsimimit të tij mund të ballafaqohet me vështirësi në mësimnxënie, por te disa nxënës të arriturat dhe sukcesi në mësimnxënie janë më të ulëta nga ato siç priten sipas moshës, aftësisë dhe potencialit. Vështirësitë me të cilat ballafaqohen këto nxënës shpesh përcillen edhe me gjendje emocionale specifike e cila ndikon në vëmendjen, perceptimin, të menduarit dhe të folurit e tyre, a me këte edhe në humbjen e motivimit për mësimnxënie.

Vështirësitë me të cilat ballafaqohen këta nxënës mund të jenë të lidhura me:

- Pamundësinë për organizimin e procesit të mësimnxënies (mënyrën e organizimit dhe manipulimit me më shumë informata në të njejtën kohë, vendosjen e tyre në koncepte, të vepruarit me ta në mënyra të ndryshme ose organizimi i materialeve dhe kohës);
- Mospasja e koncentrimit dhe pamundësisë që të ruhet vëmendja në mënyrë të mjaftueshme për atë se çka duhet të mësohet;
- Ballafaqimi me situata krize të ndryshme, siç janë: problemet emocionale (frika, dhuna e përjetuar), sëmundja e fëmijës (sëmundje kronike, hospitalizim, largimi nga shtëpia dhe familja për shkak të shërimit), problemet familjare (shkurorëzimi i prindërve, vdekja e njërit prind, anëtarë i sëmurë i familjes), gjatë së cilës për shkak të pengesave emocionale dhe vështirësive fëmija nuk është në gjendje të përkushtojë energji të mjaftueshme në procesin e mësimnxënies, ka vëmendje labile dhe është i dekoncentruar.

### Fushat e vështirësive:

- ▶ **Organizimi i të mësuarit** (caktimi ose organizimi i kohës, rregullimi ose caktimi i fillimit, mjedisi ose fundi, caktimi i prioriteteve, menaxhimi me kohën, ndjekja e rregullave dhe respektimi i afateve, organizimi i hapësirës dhe gjetja/rregullimi i materialeve).
- ▶ **Funksionet kognitive** (lidhshmëria e diturive, organizimi dhe manipulimi me më tepër informata në të njejtën kohë, klasifikimi i tyre, vendosja në koncepte, veprimi me ta në mënyra të ndryshme dhe parashikimi i zbatimit të tyre, zgjidhja e problemeve).
- ▶ **Koncentrimi dhe motivimi** (vëmendje afatshkurte, bindje për mungesën e ndihmës, motivimi i dobët, shfrytëzimi i arsyeve për mospasje, dorëzimi dhe mospranimi i obligimeve, aftësia e pamjaftueshme për funksionim efektiv edhe në kushte kur mjedisi ose të priturat ndryshojnë).
- ▶ **Sjellja dhe realizimi i lidhjeve sociale** (mungesa nga orët, mospranimi i obligimeve, sjellje joadekuate, mungesa e shprehive punuese, vështirësi në realizimin e kontakteve, bashkëpunimit dhe komunikimi me të tjerët)
- ▶ **Emocionet dhe pasqyra për veten** (shqetësimi, tërëhjekja, vështirësitë psikosomatike, vështirësi në pranimin e obligimeve, vetëbesimi i ulët, turpërimi, jodisponimi, tërëhjekja gjatë ballafaqimit me lodhjen, tërëhjekja e shpejtë, dhënia e pohimeve negative për veten, ndonjëherë edhe sjellja agresive)

### Qëllimi i përkrahjes individuale:

Më së shpeshti, për nxënësit me vështirësi të përgjithëshme në mësimdhënie, mirë është që përkrahja të orientohet nga ndihma në gjetjen e stilit vetanak të mësimnxënies dhe të ushtruarit me teknika të ndryshme të mësimnxënies, gjatë së cilës njëkohësisht punohet edhe në përforcimin e koncentrimit dhe memorimit, por në masë të madhe edhe në aktivizimin e proceseve mendore më të larta, si dhe në përforcimin e komponentës emocionale.

Bashkëpunëtorët profesional, mund ti ndihmojnë fëmijës në:

- ▶ Organizimin e mësimnxënies dhe përvetësimin e mënyrave/teknikave të mësimnxënies
- ▶ Përforcimi i kapaciteteve emocionale
- ▶ Zhvillimi i pasqyrës pozitive për veten dhe përforcimi i vetëbesimit
- ▶ Orientimi i koncentrimin dhe vëmendjes
- ▶ Nxitja dhe zhvillimi i bashkëpunimit me të tjerët.

## 2 | VËSHIRËSITË E MËSIMNXËNIES TË SHKAKTUARA NGA DEPRIVIMI SOCIAL, EKONOMIK DHE KULTUROR

Fëmijët të cilët rrjedhin nga mjediset e deprivuara sociale, ekonomike dhe kulturore, shpesh kanë vështirësi në mësimnxënie të cilat joggjithmonë janë të shkaktuara nga ndonjë lloj i pengesës.

Sipas terminologjisë së OECD: "...familjet e rrezikuara socio ekonomike janë familje të cilat nuk mundën të mundësojnë kushte elementare ose kërkesa për jetë, siç janë vendbanimi adekuat, ushqimi ose mbrojtja shëndetësore (OECD, 2010)."<sup>7</sup>

Kjo do të thotë se këta fëmijë nuk kanë kushte fillestare të njejtë si edhe fëmijët e tjerë për ti arritur rezultatet e pritura dhe të përparojnë në mësimnxënie për shkak të ndikimit të faktorëve të shumtë të cilët rrjedhin nga mjedisi i tyre jetësor: duke filluar nga mundësitë e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave ekzistenciale, nëpërmjet të barrierave të mundshme gjuhësore kur nuk e flasin gjuhën në të cilën duhet të arsimohen, deri te përkrahja e zvogëluar të cilën mund t'ju a japin prindët në mësimnxënie për shkak se të njejtët më së shpeshti nuk janë të arsimuar mjaftë.

Fëmijët e deprivuar socio-ekonomikisht më së shpeshti ritën në mjedise të vobekëta dhe rrallë mund të realizojnë interaksion adekuat dhe intelektualo-stimulativ me prindët e tyre. Hulumtimet tregojnë se këta fëmijë nuk kanë potenciale më të ulëta të lindura për mësimnxënie, por mjedisi i tyre nuk ju mundëson mënyra adekuate për ti zhvilluar potencialet të cilat i kanë. Kështu që "fëmijët nga familjet me status të ulët socio-ekonomik përparojnë më ngadalë në shkollë dhe kanë të aritura më të ulëta, ndërsa prindët në këta familje përkushtohen më pak në arsimimin e fëmijëve të tyre (OECD, 2010; APA 2012). Nxënësit nga këta familje më ngadalë e përvetësojnë gjuhën, më vonë përvetësojnë vetëdijen fonologjike dhe në masë më të madhe kanë vështirësi me leximin, (Aikens & Barbarin, 2008). Disa hulumtime të caktuara psikologjike tregojnë se ritja e fëmijëve në mjedise të deprivuara e vështirëson zhvillimin e tyre kognitiv. Fëmijët me status më të ulët socio-ekonomik nga mosha e tyre tre vjeçare dëgjojnë afër 30 milion fjalë më pak, krahasuar me fëmijët nga familjet me status më të lartë socio-ekonomik, që ka efekt të pakthyeshem ndaj formimit të formularëve mendore dhe përgatitjes për fillimin në shkollë (Howe, 1997). Studimet për mënyrën e shfrytëzimit të sintaksës dhe përdorimit të zmadhuar të përemërave (të ashtuquajturit "kodi i kufizuar gjuhësor") flasin për ate se fëmijët nga mjediset deprivuara sociale dhe kulturore kanë më pak mjedis stimulativ për zhvillimin e potencialve të tyre (Bernstajn, 1979; Ivić & Havelka, 1982)."<sup>8</sup>

E gjithë kjo flet për ate se efikasiteti kognitiv i fëmijëve nga mjediset e deprivuara sociale, ekonomike dhe kulturore duhet të shqyrtohet nga aspekti i ndikimit të vobektësisë, dallimeve kulturore dhe kushteve jo të mira dhe specifike në të cilat ritën këta fëmijë.

7 Јовановиќ В., Петровиќ Д., Милојевиќ З., Јеремиќ Ј., Лажетиќ П., Образовна инклузија деце ромске националности, Центар за образовне политике, Београд, 2013

8 Јовановиќ В., Петровиќ Д., Милојевиќ З., Јеремиќ Ј., Лажетиќ П., Образовна инклузија деце ромске националности, Центар за образовне политике, Београд, 2013

## Fushat e vështirësi

Fëmijët e deprivuar socio-ekonomikisht kanë vështirësi lidhur me:

- ▶ **Koncentrimi dhe motivimi** (vëmendje afatshkurte, bindje për mospatje ndihmë, motivim i dobët, shfrytëzimi i arsyeve për mospatje, dorëzimi dhe mospranimi i obligimeve)
- ▶ **Sjellja dhe realizimi i lidhjeve sociale** (mungesa nga orët, mospranimi i obligimeve, sjellje joadekuate, mungesa e shprehive punuese, vështirësi në realizimin e kontakteve, bashkëpunimit dhe komunikimit me të tjerët)
- ▶ **Emocionet dhe pasqyra për veten** (shqetësimi, tërëhjekja, vështirësitë psikosomatike, vështirësi në pranimin e obligimeve, vetëbesimi i ulët, turpërimi, jodisponimi, tërëhjekja gjatë ballafaqimit me lodhjen, tërëhjekja e shpejtë, dhënia e pohimeve negative për veten, ndonjëherë edhe sjellja agresive)
- ▶ **Funksionet kognitive** (interesimet e ngushta dhe sipërfaqësore, të menduarit e vështirësuar abstrakt veçanërisht në proceset e analizës dhe sintezës, vështirësitë në të shprehurit e mendimeve në të folur-të shprehurit gojor dhe me shkrim, vështirësi në lexim, shkrim dhe operacione matematikore, jokritik veçanërisht në ballafaqim me rreziqet).

## Qëllimi i përkrahjes individuale:

Duke patur parasyshë shkaqet për paraqitjen e vështirësi në mësimnxënie të këta nxënës, aktivitetet në shkollë do të duhet të orientohen nga kompenzimi i kushteve joadekuate në të cilat rriten fëmijët me ate që do t'ju mundësohet mjedis stimualtiv shkollor dhe mundësi për ti realizuar potencialet e tyre. Kjo do të thotë se përkrahja individuale duhet të orientohet në përvetësimin e shkathtësi me çka do të zvogëlohet pabarazia fillestare dhe do të mundësohen kushte për nxitje dhe zhvillim të potencialeve me të cilat disponojnë këta fëmijë.

Bashkëpunëtorët profesional mund ti ndihmojnë fëmijës në:

- ▶ Zhvillimin e pasqyrës pozitive për veten dhe përforcimin e vetëbesimit
- ▶ Zhvillimi i të folurit dhe shkathtësi komunikative
- ▶ Krijimi dhe zhvillimi i shprehive për kujdesin për vete dhe sigurinë personale
- ▶ Nxitja dhe zhvillimi i bashkëpunimit me të tjerët dhe respektimi i tyre
- ▶ Organizimi i mësimin të mënyrat e mësimnxënies

Format e tjera të përkrahjes mund të planifikohen varësisht nga ajo se a janë shkaktuar vështirësitë edhe nga ndonjë lloj pengese ose janë si pasojë e ndikimit të faktorëve të cilët rrjedhin nga mjedisi i tyre jetësor

## 3 | VËSHIRËSITË SPECIFIKE NË PROCESIN E MËSIMNXËNIES

Vështirësitë specifike në mësimnxënie kanë të bëjnë me fëmijët të cilët nuk mundet ti përvetësojnë shkathtësitë elementare shkollore ose të njëjtat ti përvetësojnë në nivel të ulët të arriturave të shprehura në përqindje, gjegjësisht nuk mundet të mësojnë të lexojnë, të shkruajnë ose të punojnë me numra në korniza kohore e cila është e paraparë për ate dhe në mënyrë e cila te të tjerët në pjesën më të madhe të fëmijëve shpjen deri te suksesi.

Për vështirësitë specifike në mësimnxënie me rëndësi është të përmendet se:

- vështirësia e shkaktuar nga çrregullimi i një ose më tepër proceseve në sistemin kognitiv të cilat kanë të bëjnë me proceset psikologjike të kyçura në të kuptuarit dhe në shfrytëzimin e gjuhës në formën e saj të shkruar ose të shprehur, në të kuptuarit dhe shfrytëzimin e numrave dhe operacioneve matematikore dhe në mundësinë që mjaft gjatë të ruhet koncentrimi me një aktivitet;

- manifestimi i këtyre vështirësive është i dukshën në një ose më shumë fusha, gjegjësisht funksione bazike, siç janë: vëmendja, të mbajturit mend, perceptimet, komunikimi, leximi, shkrimi, njehsimi, koordinimi, kompetencat sociale, pjekuria emocionale;
- fushat/funksionet e lartpërmendura janë me rëndësi të veçantë për zhvillimin e suksesshëm të procesit të mësimnxënies por edhe për aftësimin e fëmijës për funksionim jetësor;
- këta vështirësi janë afatgjate dhe tërhiqen gjatë tërë jetës në personin i cili i ka, por me zhvillim dhe përparim të funksioneve bazike, ndikimi i çrregullimeve të cilat shkaktojnë vështirësi në mësimnxënie zvogëlohet.

Për këtë shkak, me rëndësi të veçantë është që të dihen karakteristikat e llojit të çrregullimit me çka do të mundet përkrahja individuale të orientohet nga zhvillimi i atyre funksioneve të cilat janë më të shumti në ndikimin e atij çrregullimi.

### 3.1. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga mungesa e vëmendjes / çrregullimi hiperaktiv

ADHD paraqet çrregullim zhvillimor të vetëkontrollit, gjegjësisht sindrom, përmbledhje e simptomeve të mungesës së vëmendjes, hiperaktivitetit dhe impulsivitetit.

**A – Attention – vëmendja**

**D – Deficit – mungesë**

**H – Hyperactivity – hiperaktivitet**

**D – Disorder – çrregullim**

Disa fëmijë në një periudhë të jetës së tyre janë jo të urtë, impulsiv, nuk kujdesen mjaft gjatë mësimnxënies ose realizimit të ndonjë aktiviteti. Prapë se prap nuk mund të themi se bëhet fjalë për hiperaktivitet. Kur sjellja e këtillë do të jetë dukshëm më e shprehur nga ajo që logaritet si e zakonshme dhe karakteristike për moshën dhe shkallën e zhvillimit të fëmijës dhe kur në shkallë të caktuar do të çrregullohet funksionimi i fëmijës në aspekte të ndryshme të jetës së tij atherë simptomat e këtilla do të mundej të lidhen me hiperaktivitetin.

#### Si manifestohet?

Vështirësitë kyçe te fëmijët me ADHD janë në proceset e rregullimit të vëmendjes, mosplotësimin me sjellje impulsive, aktiviteti i shprehur psikomotorik-hiperaktiv dhe inhibicioni. Te disa fëmijë mund të jetë dominuese vëmendja afatshkurte, te të tjerët hiperaktiviteti dhe impulsiviteti, ndërsa te disa me shpeshmëri dhe fuqi të njejtë mund të paraqiten e dhe vështirësi me vëmendjen dhe hiperaktivitetin. Ky sindrom paraqitet me nënloje, varësisht nga ajo se simptomat kryesore janë lidhur me hiperaktivitetin dhe impulsivitetin ose jokencntrimin/vëmendje e çrregulluar.



Hiperaktiviteti dhe impulsiviteti	Vëmendja e çrregulluar
<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Mosdurimi shprehës (pamundësia që të presë rradhën e tij; punon shumë shpejt dhe bën gabime)</li> <li>▶ Joqetësia psikomotorike (ulja jo e qetë në karige; ngritja në situata kur kërkohet të jetë ulur, pritja në rradhë, padurimi; vrapimi, ngjitja, lëvizje e vazhdueshme)</li> <li>▶ Vështirësi për të luajtur i relaksuar dhe në qetësi</li> <li>▶ Llafazan, shpesh pyet a nuk pret përgjigjen</li> <li>▶ Përgjigje të shpejtuara dhe jo të menduara mirë, pa pritur ta dëgjon pyetjen deri në fund dhe pa menduar,</li> <li>▶ Ndërrime të shpeshta të aktiviteteve, duke i lënë të papërfunduar parapraken</li> <li>▶ Shpesh ndërpret bisedën dhe aktivitetet e të tjerëve, ndërhyr në fjalë, në lojën e të tjerëve</li> <li>▶ Vështirësi në organizim (harsa, humbja e gjëseneve, vështirësi gjatë të mbajturit mend të udhëzimeve)</li> <li>▶ Reagimi i pamenduar për pasojat e mundëshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Mossukses gjatë koncentrimin në detaje</li> <li>▶ Bërja e gabimeve (në detyra, aktivitete)</li> <li>▶ Vështirësi gjatë ruajtjes së vëmendjes në detyrë</li> <li>▶ Ekziston përshtypja se nuk dëgjon kur i drejtoheni në mënyrë direkte</li> <li>▶ Mospërcjellja e instruksioneve deri në fund dhe pamundësia ti kryen obligimet</li> <li>▶ Vështirësi gjatë organizimit në punë</li> <li>▶ Lehtë i humb gjësendet e domosdoshme për funksionimin e përditshëm</li> <li>▶ Tërhiqja e lehtë e vëmendjes nga stimuluesit e jashtëm jo të rëndësishëm</li> <li>▶ Është e nevojshme rikujtim për ti kryer aktivitetet e përditëshme</li> </ul>

### Fusha e vështirësive

Nxënësit me sindromin ADHD kanë vështirësi në fushat vijuese:

- ▶ **Vëmendja dhe koncentrimi** (vëmendje afatshkurte dhe joselektive, paaftësi për orientim dhe ruajtje të vëmendjes).
- ▶ **Perceptimi** (vështirësi në perceptimet e të dëgjuarit dhe shikimit, vështirësi gjatë lateralizimit/lateralizim jo i sigurtë në veten e cila shpesh është pasqyrë e orientimit të dobët në kohë, probleme gjatë vështrimit të raporteve pjesë-tërësi).
- ▶ **Motorika** ( jo i qetë, jo i kujdesshëm, nevoja për aktivitet dhe lëvizje, vështirësi në kontrollimin vetanak për qetësim).
- ▶ **Emocionet dhe raportet sociale** (impulsiviteti, prag i ulët i tolerancës dhe frustracioneve, pa parashikim, i dhënë në sulme me tërbim dhe destruktivitet, i cili rezulton në mospranimin nga ana e bashkëmoshatarëve dhe status të ulët sociometrik).
- ▶ **Funksionet kognitive** (të mnduarit e dobët abstrakt, mosorganizim, vështirësi në formimin e koncepteve, vështirësi me të mbajturit mend, vështirësi në lexim, shkrim dhe operacione matematikore).

Fëmijët me ADHD dallohen nga fëmijët e tjerë në raport me funksionimin kognitiv, senzitivitetin emocional dhe shkallën e aktivitetit. Memorimi i tyre punues nuk është gjithmonë i zhvilluar deri në atë shkallë siç është te fëmijët e tjerë të moshës së njejtë, prandaj për këte, për ata është shumë e vështirë që ta kontrollojnë aftësinë për koncentrim, planifikim dhe organizim të informatave. Gjithashtu me rëndësi është që të potencohet se të gjithë fëmijët nuk tregojnë simptome të njehta dhe se paraqitja e simptomave varet nga situata të cilën gjendet fëmija. Më së shpeshti fëmijët kanë vështirësi në situata kur nga ata kërkohet vëmendje afatgjate ose mudi mental ose gjatë aktiviteteve të cilat për ata nuk janë inetersante (p.sh. përsëritja e lëvizjeve të njehta, leximi i tekstit të gjatë, dëgjimi i ligjeratës... Ndryshimet në mjedis dhe hapësirë, siç janë lëvizjet në hapësirë, zhurma, shumë njerëz në hapësirë të vogël ose shumë aplikacione në muret e klasës, shkaktojnë shqetësim dhe pengesa gjatë koncentrimin. Në sjelljen e fëmijëve ndikojnë edhe ndryshimet atmosferike, gjatë së cilës fëmija shqetësohet, vështirë mundet të koncentrohet dhe vështirë mëson.

Numër i caktuar i nxënësve me ADHD kanë vështirësi specifike me mësimnxënien, konkretisht vështirësi me shkrimin dhe leximin, për këtë shkak ata ngecin në përvetësimin e materialit mësimor. Kjo është pasojë e asaj që nuk mundet të koncentrohen gjatë njëlloj sikurse nxënësit e tjerë. Vëmendja afatshkurte ndikon edhe ndaj perceptimit të tyre dhe për këtë shkak shpesh lëshojnë informata të rëndësishme ose udhëzime të cilat ju a ka dhënë arsimtari. Këta vështirësi më tutje ndikojnë edhe në sjelljen e tyre të përgjithëshme, por edhe në kualitetin e interaksionit të realizuar me fëmijët e tjerë, të cilët ndonjëherë i përqeshin dhe i anashkalojnë.

Sipas Barklit (2000) dhe Strokut (2003), vështirësitë janë më të vogla nëse fëmija në situata të tilla është nën kontrollin e strukturuar dhe të mirëfilltë, gjegjësisht nëse merret me ndonjë aktivitet inetersant për te dhe nëse është në interaksion njëri ndaj tjetrit me person të ritur (arsimtar, psikolog, pedagog, defektolog) ose kur është i shpërblyer për sjelljen e duhur.

### Qëllimet e përkrahjes individuale

Nëpërmjet të përkrahjes individuale bashkëpunëtorët profesional duhet ti ndihmojnë fëmijës:

- ▶ Ti përforcojë aftësitë perceptive
- ▶ Të mundet ta orientojë edhe në periudhë më të gjatë ta ruan vëmendjen
- ▶ Ti organizojë informatat dhe të formojë koncepte
- ▶ Ta zvogëlojë presionin, shqetësimin dhe frustracionin
- ▶ Të mundet ta vetërregullojë sjelljen personale.

Me këtë njëkohësisht i ndihmohet fëmijës që të ketë më tepër qasje për udhëheqje nga ana e arsimtarit dhe prindit, si dhe të jetë më shpesh nën kontrollën vetanake. Kjo nuk do të thotë se vështirësitë do të zhduken përgjithmonë, por në rast se nuk bëhet asgjë, numri dhe llojet e mosukseseve me të cilat fëmija ballafaqohet do të rriten, a me këte problemet primare (vëmendja dhe hiperaktiviteti) do të rindërtohen edhe me probleme emocionale dhe çrregullime në sjellje.

Fëmijët hiperaktiv shpesh kanë vështirësi në mësimnxënie jo për shkak të mospasjes së mungesës së aftësive, po pikërisht për shkak të vështirësive emocionale. Për këte shumë me rëndësi është që aktivitetet gjatë përkrahjes individuale të orientoohen nga zvogëlimi i frustracionit, presionit, shqetësimit dhe frikës nga mosuksesi, ndërsa nga zmadhimi i ndjenjës së rëndësisë dhe përfshirjes.

### 3.2. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga çrregullimi i procesit të leximit - Disleksioni

Në shkolla hasim fëmijë të cilët procesi i mësimnxënies së shkrimit dhe leximit zhvillohet dukshëm më ngadalë se sa te fëmijët e tjerë, me më shumë mundim, a me shumë më pak sukses. Një pjesë e këtyre fëmijëve deri në fund të klasës të parë të paraparë për shkrim lexim, bile edhe në pjesën e parë të klasës së dytë nuk mundën asesi të lexojnë. Në rast se bëhet fjalë për nxënës me aftësi mesatare intelektuale, shkak mundet të jetë disleksia.

„Disleksia (dys – dobët, keq; lexis – gjuhë, fjalë) paraqet vështirësi gjuhësore e bazuar me prejardhje konstitutive, ndërsa e karakterizojnë vështirësitë në dekodimin (deshifrimin) e fjalës së lexuar (leximi-të kuptuarit) këta vështirësi janë të papritura në raport me moshën, aftësitë intelektuale dhe arsimore, ndërsa nuk janë rezultat i çrregullimeve të përgjithëshme zhvillimore ose sensorike, siç janë dëmtimet e të pamurit ose dëgjimi (sipas Orton Dyslexia Society Research Comittee, 1996)“<sup>9</sup>.

Vështirësitë kyçe te fëmijët me disleksi janë vështirësitë në procesin e bashkimit të shkronjave dhe rrokjeve dhe të lexuarit automatik të fjalëve të tëra, të cilat janë shpesh të përcjella me të kuptuarit jo të mjaftueshëm të asaj që është lexuar dhe vështirësi të shprehuri gojorë. Vetëdisleksia nuk paraqet problem të vetëm të leximit, por bëhet fjalë edhe për problem të folurit dhe psikomotorik.

9 Бјелица Ј., Галиќ Јушиќ И., Посокхова И., Првчиќ И., Ристер М., Павлиќ Котиеро А., Приручник о дислексији, дисграфији и сличним тешкоћама у читању, писању и учењу, Загреб, 2005

Disleksioni paraqitet në format vijuese:

<p><b>Disleksioni me të shprehurit gojor me formim të pamjaftueshëm</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Të shprehurit gojor jo të zhvilluar mjaftueshëm ose pengesa të buta në të shprehurit (netlla-neklla)</li> <li>▶ Fjalor i vobekët</li> <li>▶ Memorimi i dobët dëgjues-folës (nuk mundet saktësisht me rradhë të përsërit 3 deri 5 fjalë).</li> </ul>
<p><b>Disleksioni me perceptim vizuelo – hapësinor me formim të pamjaftueshëm</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Të folurit gojor i rregullt</li> <li>▶ Të gjendurit e vështirësuar në vargje kohore dhe hapësinore (majtas-djathtas; para-prapa; rradhitja e ditëve në javë ose muajve në vit))</li> <li>▶ Zëvendësimi i shkronjave në forma të ngjashme (kal-kat; zorë-sorë)</li> </ul>
<p><b>Lloji i kombinuar i disleksionit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Të lexuarit shkronjë pas shkronje në periudhë të gjatë</li> <li>▶ Të lexuarit përmendësh</li> <li>▶ Zëvendësimi i zanoreve (ku-ka)</li> <li>▶ Lëshimi i tingujve (bora-boa)</li> <li>▶ Shtimi i tingujve (dita-drita)</li> <li>▶ Zëvendësimi i rokjeve në fjalë (televizor-letevizor)</li> <li>▶ Kërcim i reshtave</li> <li>▶ Përsëritja e reshtave të fjalës (dera-ra)</li> <li>▶ Zëvendësimi i tingujve të ngjashëm (k-g, t-n, d-n)</li> </ul>

### Si manifestohet?


Për disleksinë janë karakteristike **vështirësi dhe specifika** në fushat vijuese:

**Lexim** – vështirësi në shpejtësi, rrijedhshmëri, saktësi dhe shkallë të të kuptuarit të asaj që është lexuar.

**Përpunimi fonologjik i fjalëve** – vështirësi gjatë përpunimit të tingujve në fjalë. Fëmija vështirë vetëdijësohet për tingujt në fjalë, kështu vështirë mundet që ti ndan tingujt fillestar ose të fundit ose vështirë e vëren ritmin e rimës së fjalëve.

**Të shkruarit** – vështirësi gjatë formulimit, rregullimi dhe organizimi i shkronjave dhe shkrimit ose vështirësi në formulimin e pavarur të tekstit.

**Perceptimi vizuel** – perceptim i ndryshuar i shkronjave – humbja e disa pjesëve të shkronjave ose fjalëve, levizja ose rrotullimi i shkronjave, humbja e reshtave në tekst, humbja e pjesëve të fjalisë ose fillimi ose mbarimi i fjalës, mosorientimi në kahjet majtas-djathtas, lartë-poshtë (fig. 1).




	<p>matched control group. SIGNIFICANT IMPROVEMENT FOR THE EXPERIMENTAL GROUP WAS NOTED FOR TIME NEEDED TO LOCATE WORDS ON A PRINTED PAGE, TIMED READING SCORES, LENGTH OF TIME FOR SUSTAINED READING, AND SPAN OF RECALLS, AS WELL AS OTHER PERCEPTUAL TASKS. ADDITIONALLY, SEVEN OF THE 23 EXPERIMENTAL FOUND EMPLOYMENT, BUT NONE OF THE CONTROL GROUP WAS EMPLOYED BY THE END OF THE SEMESTER.</p> <p>In contrast, Winters (1987) was unable to find differences initially. Winters gave 15 elementary school children four minutes to locate and circle 68 examples of the letter 'b' on three pages, each page of which contained 600 random letters in 20 lines of</p>
<p>an epink shidwhokpnaipom formy wewebd wall and theback wenten hallrang Bill grabbed the toy withpinkshir beforehe could leave. However, by theend of theday hehad decidedthat this schoolwasworse than the last oneeven though he didn'tlikeit. Nobodyhad offeredto pullhishead off, niphadnot offered hisshoes overthe roof, or theotherhand, nobody hadspoken tohimbefore by Thursdayafter noon, nothinghad changedand it was noticeably superiorandnospoke tohimbecause no onehadspoke tohim everydayhe was withanother group. Nobody sawhim together at registration after thatthey were split up for all their lessons. Keith with his Englishwith the queen with 2yale was on the end of that periodwas a no-wiser about it than he had been at the beginning, it seemed that the class was in fact 15 weeks and the teacher was on page 113 of the book but both books had identical covers the lesson was over before any completed Bill had however, by the end of the day he had decided that this school was better than the last one even though he didn't like it. Nobody had offered to pull his head off, niphadnot offered his shoes over the roof, or the other hand, nobody had spoken to him before by Thursday after noon, nothing had changed and it was noticeably superior and no spoke to him because no one had spoke to him every day he was with another group. Nobody saw him together at registration</p>	<p>Wider application initiatives are being used in many non-dyslexic students would benefit from similar methods but would not be a funding priority. The knowledge of mapping an her study skills technique is being spread across a wide demographic could benefit students.</p> <p>preferences regarding all readers, dyslexics in particular, centred can be used for headings or titles. Aligned right and justified causes problems, aligned right causes confusion with flowing to the next line. Justified text creates non-consistency of word spacing, and this can lead to the river-of text distortion. Very important is the strong advice against hyphenation, the words split and there fore causes difficulty in comprehension. As an overall remark I'd like to emphasise not to provide a 'learn-ho-to-read' visual, but to focus on clarity, consistency and space, used initials</p>

Figura 1. Mënyrat se si personat me disleksion e shikojnë tekstin<sup>10</sup>

**Të mbajturit mend** – vështirësi në memorimin afatshkurtër gjatë se cilës është pamundësuar të mbajturit mend e radhitjes së rrokjeve, dhe me këte edhe lidhshmëria e tyre në fjalë.

**Sekuencat** – vështirësi në gjendshmërinë në vargjet kohore-hapësinore.

**Organizimi i informatave** – mosorganizimi në grumbullimin dhe përpunimin e informatave.

**Pabarazia në aftësi** – aftësi të shprehura të larta në fusha të caktuara dhe aftësi të shprehura ulët në fusha të tjera. Sipas hulumtimeve “fëmijët me disleksi kanë shkallë të Vegslerit të intelegjencës të ashtuquajtur ACID profil ose rezultate të ulëta në nëntestet për njehsim, të mbajturit mend të numrave dhe informime, ndërsa rezultatet nga nëntestet për gjetjen e ngjashmërive, të të kuptuarit dhe formimit të kubeve janë dukshëm më të mira.”<sup>11</sup>

**Gjuha dhe konceptet** – nodnjëherë fëmijët ballafaqohen me vështirësi gjuhësore dhe për ate se të shprehurit e përparuar gjuhësor më shpesh ndërtohet në bazë të të mësuarit të gjuhës së shkruar nëpërmjet të lexuarit të teksteve, e cila gjë te fëmijët me disleksi vështirë zhvillohet.

<sup>10</sup> Marrë nga [http://marul.ffst.hr/~batarelo/PPDMO/posebnepotrebe/predavanja/PPP\\_1ldio.pdf](http://marul.ffst.hr/~batarelo/PPDMO/posebnepotrebe/predavanja/PPP_1ldio.pdf) (Педагогика дјеце с посебним потребама – Ивана Батерло Кокиќ)

<sup>11</sup> Michael E.Thompson, E. J. Watkins, Dyslexia, A Teaching Handbook, Whurr Publishers, London, 2000

## Fushat e vështirësive

Nxënësit me disleksi kanë vështirësi në fushat vijuese:

- ▶ **Vëmendja dhe koncentrimi** (funksione sukcesive, jo të zhvilluara mirë, vëmendje afatshkurte dhe joselektive)
- ▶ **Perceptimi** (vështirësi në perceptimin hapësinor dhe perceptimin kohor)
- ▶ **Motorika** (vështirësi gjatë koordinimit, orientimit, lëvizjeve ritmike)
- ▶ **Emocionet dhe raportet sociale** (papjekuri e dëshirës dhe emocioneve, lodhja e shpejtuar energjetike – lodhje e shpejtuar dëshirë e dobësuar e organizimit të aktiviteteve mentale – kundërshtim nga leximi dhe mësimnxënia, humbja e vetëbesimit, pakënaqësia me vetëveten, frustrimi)
- ▶ **Funksionet kognitive** (mosorganizimi; vështirësitë në organizimin e informatave dhe formimin e koncepteve; vështirësi në të mbajturit mend afatshkurtë; vështirësi në lexim; shkrim dhe operacione matematikore).

Fëmijët me disleksi mendojnë për fotografitë dhe fjalët për të cilat munden të formojnë fotografi për ta nuk paraqesin problem. Problemi paraqitet kur ndëmjete fjalëve për të cilat formohet fotografia (shtëpia, druri, macja) do të gjenden fjalë për të cilat nuk mund të formohet fotografi (nëse, kur, gjithmonë, kush). Atëherë paraqitet e ashtuquajtura fotografi e zbrazët dhe shqetësim, në këtë rast fëmija e kërcen atë fjalë ose e shqipton me vështirësi, jo si duhet dhe gjatë. Kjo sjell deri te shqetësimi dekoncentrimi dhe lodhja, ndërsa fëmija në realitet nuk ka kuptuar asgjë nga ajo që ka lexuar.

Fëmijët me disleksi, gjithashtu, kanë vështirësi gjatë ruajtjes së kujtesës së fotografive të fjalëve, si dhe në zberthimin e fjalisë në rokje ose fonema dhe në formimin e sërishëm të tyre. I përzien numrat e ngjashëm ndërmjet veti: 7-1, 5 - 3, 6 - 9 ose numrat dyshifrorë 23 - 32, 57 - 75 , 34 - 43, ndërsa vështirësi kanë edhe me simbolet për katër operacionet matematikore: mbledhje (+), zbritje (-), shumëzim (.), pjesëtim (:). Dëgjimi, identifikimi, si dhe të mbajturit mend të shkronjave dhe fjalëve kërkojnë koncentrim, kohë dhe reagim të shpejtë, që është e vështirë për fëmijët me disleksi dhe shkakton stres dhe raksione emocionale negative.

## Qëllimi i përkrahjes individuale

Bashkëpunëtorët profesional nëpërmjet të përkrahjes mund ti ndihmojnë fëmijës:

- ▶ Të zhvillojë perceptimin vizuelo-hapësinor
- ▶ Të mundet ta orienton në periudhë më të gjatë ta ruan vëmendjen
- ▶ Të zhvillojë grafomotorikën e vogël dhe shkathtësitë e shkrimit.
- ▶ Të zhvillojë të menduarit suksesiv, vizuel dhe dëgjues-verbal
- ▶ Të zhvillojë simbolikën grafike
- ▶ Të ushtrojë organizimin e informatave
- ▶ Të përmirësojë të kuptuarit e tekstit të lexuar
- ▶ Të zgjerojë fjalorin
- ▶ Të zvogëlojë frustrimin dhe presionin emocional

### 3.3. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga çrregullimi i procesit të shkruarit - Disgrafia

„Disgrafia është paaftësi stabile e fëmijës për ta përvetësuar shkathtësinë e të shkruarit e cila vërehet nëpërmjet gabimeve të shumëta dhe tipike të cilat nuk janë të lidhura me mosdijen e drejtëshkrimit, si dhe me shkallën e zhvillimit intelektual shprehës.”<sup>12</sup>

Karakteristike është se shpesh bëhen gabime jo të zakonata, specifike dhe se të njejtat gjithmonë përsëriten.

<sup>12</sup> Школа ПУНа могућности, Програм увођења помоћника у настави, Европска унија, Европски структурни и инвестициски фондови, ЕСФ, град Задар, 2016, стр. 49

Disgrafia paraqitet në format vijuese:

Sipas shkaqeve
Disgrafia trashëguese
Disgrafia e fituar – e shkaktuar nga faktorët e jashtëm jo të përshtatshëm në zhvillim
Lloji i kombinuar i disgrafisë – kombinimi i paradispozitave me ndikim të faktorëve të jashtëm

Sipas shkallës se sa janë të shprehura
Disgrafia e lehtë
Disgrafia e shprehur
Agrafia – joaftësia e plotë për shkrim, e përcjellur me vështirësi serioze specifike në mësimnxënien fillestare, veçanërisht të shkronjave

Sipas sindromit dominues	
<b>Disgrafia fonologjike (auditive)</b> Gabimet në të shkruarit janë shkaktuar nga vështirësitë e të folurit ose nga dallimet e tingujve të dëgjuara. Manifestohet në nivel të shkronjave dhe të fjalëve.	<b>Disgrafia artikularo-akustike</b> – fëmija gabim i thekson tingujt dhe të njejtën e bën edhe gjatë të shkruarit si i thekson ashtu edhe i bart me shkrim)
	<b>Disgrafia foneme</b> – vështirësi në dallimin e dëgjuar të tingujve të cilat ngjashëm theksohen, sjellin deri në gabime gjatë shkrimit (sorra-zorra; buka-puka)
<b>Disgrafia gjuhësore</b>	<b>Disgrafia e analizës dhe sintezës gjuhësore</b> – vështirësi gjatë zbërthimit të tekstit në fjali, fjalitë në fjalë, fjalët në rrokje, etj. Të cilat kanë të bëjnë me analizën gjuhësore joformale dhe sintezën në shkallë të ndryshme.
	<b>Disgrafia gramatikore</b> – vështirësi në fomrulimin gramatikor të fjalëve dhe fjalive dhe lidhshmëria e gabuar e fjalëve.
<b>Disgrafia vizuale</b> – vështirësi në perceptimin dhe orientimin vizuelo-hapësinor të cilët ndikojnë në procesin e të shkruarit dhe manifestohen nëpërmjet të përzierjes dhe deformimit të shkronjave. Fëmija vështirë i përvetëson format grafike të disa shkronjave dhe i përziën përziën vizuelisht shkronjat e ngjashme.	
<b>Disgrafia grafomotorike</b> – është e lidhur me funksionet motorike jo të zhvilluara mirë dhe manifestohet nëpërmjet të përzierjes së shkronjave sipas afërsisë, shkrim jostabil dhe jo i lexueshëm, përshkrim ose lëshim i elementeve në shkronja, zëvendësim i shkronjave të ngjashme, madhësi e jo barabartë e shkronjave, shkrim jo i rrafshuar, shkrim i ngadalshëm dhe lodhje e shpejtë.	

## Si manifestohe?

Për disgrafinë **karakteristike janë vështirësitë vijuese::**

Gabime në fushën e shkronjave dhe rrokjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Lëshime (shkronja-shkronja; karrige-karrige)</li> <li>▶ Zhvendosje – vështirësi në vëzhgimin e radhitjes së shkronjave në fjalë (akoma-kaoma; personi;presoni)</li> <li>▶ Të shtuarit e shkronjave fletore-fletore; mjegulla-mjegualla)</li> <li>▶ Perseveracioni – ngatërimi, përsëritja e shkronjave ose rrokjeve (mbeturina-mbeturinana)</li> <li>▶ Anticipimi shpejtimi para – kur tingulli i nevojshëm zëvendësohet me tingull tjetër i cili është prezent në fjalën vijuese (“gogor” – logor)</li> </ul>
Gabime në fushën e fjalëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Të shkruarit e ndarë të fjalës së njejtë (mbi vlerësim)</li> <li>▶ Të shkruarit e fomuar nga dy fjalë (nëdegë)</li> <li>▶ Fjalë të derdhura – mospatja e kufinjëve</li> </ul>
Gabime në fushën e fjalive	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Lidhja e fajlive në fjali</li> <li>▶ Interpunktimi jo i rregullt</li> </ul>




Figura 2. PShembuj nga shkrimi disgrafik<sup>13</sup>

## Fushat e vështirësive

Nxënësit me disgrafi kanë vështirësi në fushat vijuese:

- ▶ **Vëmendja dhe koncentrimi** (vështirësi në fokusim, vëmendje afatshkurte)
- ▶ **Perceptimi** (vështirësi në **sekuencat vizuale** –të lexuarit e mbrapsht të shkronjave të caktuara ose vargjeve të shkronjave; vështirësi në **perceptimin hapësinor** –vështirësi në dallimin majtas-djathtas, gjatë së cilës shpesh edhe shkrimi nuk është i barabartë me valëzimin e shkronjave ndonjëherë nga ana e majtë e ndonjëherë nga ana e djathtë, disa shkronja janë të vogla, ndërsa disa të mëdha; vështirësi në **perceptimin auditiv** – dallim, të mbajturit mend, analizë dhe sintezë të tingujve)
- ▶ **Motorika** ( funksione grafomotorike të vrazhda dhe të buta jo të zhvilluara mirë – shkrim jo i mirë; vendosje e keqe e shkronjave, ndonjëherë të përmirësuar me rivizatim të pjesëve, reshta të thyer, të valëzuar ose të pjerët, fjalë të cilat janë të shtypura ndërmjet veti, ndonjëherë shtypje e fuqishme në fletë)
- ▶ **Emocionet dhe raportet sociale** (papjekuri e dëshirës dhe emocioneve, lodhje e shpejtuar energjetike – lodhje e shpejtë, organizim i dobët i dëshirës për aktivitete mentale – kundërshtim ndaj të shkruarit dhe mësimnxënies, humbje e vetëbesimit, pakënaqësi me vetëveten, frustrim)
- ▶ **Funksionet kognitive** ( vështirësi në të mbajturit mend vizuel dhe dallimi i shkronjave, në të folurit impresiv dhe ekspresiv, mosorganizim, vështirësi në formimin e koncepteve, vështirësi me të mbajturit mend afatshkurtë, vështirësi në shkrim, lexim dhe operacione matematikore)

<sup>13</sup> Marrë nga <http://www.inkluzija.org/biblioteka/Bodriti%20dobre%20oil%20dobriti%20bodre.pdf>

## Qëllimi i përkrahjes individuale

Nëpërmjet të përkrahjes individuale bashkëpunëtorët profesional duhet ti ndihmojë në:

- ▶ Zhvillimin e grafomotorikës
- ▶ Diferencimit të raporteve hapësinore në fushën grafomotorike
- ▶ Zhvillimin e aftësive perceptive
- ▶ Përmirësimin e koncentrimin dhe fokusimit
- ▶ Përmirësimin e diskriminimit auditiv
- ▶ Zvogëlimin i presionit emocional dhe frustrimit
- ▶ Të ushtruarit e shkrimit, leximit dhe përvetësimit të koncepteve themelore matematikore

### 3.4. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuar nga çrregullimi në procesin e nxjerrjes së operacioneve matematikore - Diskalkulia

Diskalkulia është përmbledhje e vështirësive specifike në mësimnxënien e matematikës dhe realizimin e operacioneve matematikore. Bëhet fjalë për lëshime të cilat shkaktojnë vështirësi serioze në përvetësimin e matematikës. Pa marrë parasyshë shkallën e mirë të zhvillimit intelektual, funksionimin normal të shqisave dhe ekzistimin e kushteve optimale për mësimnxënie.

Dallohen në mënyrë terminologjike:

- ▶ **Diskalkulia** – çrregullimi i pjesërishëm në procesin e përvetësimit të matematikës, i cili mund të paraqitet në të gjitha fushat ose vetëm në fusha të caktuara të matematikës. Fëmija përparon në përvetësimin e matematikës, por dukshëm më ngadalë dhe në mënyrë joadekuatë në moshën mentale të tij.
- ▶ **Akalkulia** – paaftësi e plotë për përvetësimin e matematikës, gjegjësisht mungesë e plotë e të menduarit matematikor.

Diskalkulia paraqitet në **format** vijuese:

- ▶ **Verbale** – çrregullimi i të kuptuarit dhe i përdorimit të fjalorit matematikor
- ▶ **Praktognostike** – çrregullim i aftësisë për manipulim me objekte të vizatuara se reale
- ▶ **Leksike** – çrregullim i aftësisë për lexim të simboleve matematikore dhe kombinimi i tyre
- ▶ **Grafike** – çrregullim i aftësisë për të shkruar simbole matematikore
- ▶ **Ideognostike** – çrregullim i aftësisë për të kuptuar konceptet matematikore dhe njehsimin në vete
- ▶ **Operuese** – çrregullim i aftësisë për realizimin e operacioneve matematikore.

Te fëmijët më shpesh bëhet fjalë për diskalkulinë zhvillimore, gjegjësisht për vështirësitë të cilat paraqiten në periudhën e hershme zhvillimore dhe karakterizohet me disproporcion ndërmjet moshës mentale dhe zhvillimit të aftësive matematikore. Diskalkulia mundet të jetë edhe e pavarur dhe vështirësia e vetme e cila paraqitet te fëmija, por edhe të jetë e kombinuar me vështirësi të tjera, si për shembull me disleksi.

### Si manifestohet?

- ▶ **Substitucionet parafazore** – përdorimi i gabuar i numrave gjatë leximit, shkrimit dhe zgjidhjes. Është karakteristike zëvendësimi i njërit numër me numër tjetër gjatë shkrimit dhe leximit të numrave, por edhe gjatë përdorimit të kalkulatorit, gjatë së cilës zëvendësimi nuk ka të bëjë me ngjashmërinë e formave ose pozitës hapësinore të numrit.
- ▶ **Perseveracioni** – ngatërimi. Karakteristike është përsëritja e aktivitetit të njëjtë disa herë dhe pamundësia për të kaluar në hapin vijues. Si për shembull operacioni i zbatuar në detyrën e parë zbatohet edhe në të gjitha të tjerat, edhe pse ajo nuk kërkohet në detyrat e tjera.
- ▶ **Pasqyra** – rrotullimi i numrave ose rradhitshmëria e tyre.



- ▶ **Vendosja e numrave në pozitë jopërkatese të ndërsjelltë** në reshta, kolona ose në kahjen e mundëshme të çrregulluar për zgjidhje (nga ana e djathtë në të majtën ose të kryqëzuar).
- ▶ **Gabimet vizuale** – njohje e gabuar e simboleve matematikore (+ e njëj si -) ose numra .
- ▶ **Gabimet procedurale** – lëshimi ose kërcimi i hapave obligativ në zgjidhjen e detyrave.
- ▶ **Të mbajturit mend të dobët dhe njohja e vargjeve të numrave**
- ▶ **Ngadalshmëria** – fëmijës i nevojitet më tepër kohë për zgjidhjen e operacioneve më të thjeshta matematikore.

Gjatë mësimnxënies së matematikës, fëmijët me diskalkulim kanë probleme në të kuptuarit dhe emërimin e koncepteve matematikore, operacioneve dhe koncepteve, vështirësi gjatë dekodimit (dehifrimin) të detyrave tekstuale në simbole matematikore që është e lidhur me aftësitë linguistike.

Nga aspekti i aftësive matematikore këta fëmijë kanë vështirësi në numërim, kryerjen e operacioneve matematikore dhe ndjekjen e rradhitjes së operacioneve; të mësuarit e tabelës së shumëzimit dhe pjesëtimit.

Fëmijët me diskalkuli kanë vështirësi lidhur me perceptimet dhe vëmendjen e cila manifestohet nëpërmjet të vështirësive në njohje dhe lexim të simboleve matematikore, përshkrim jo të rregullt të numrave dhe simboleve dhe mbajtje e vështirë mend e numrave.

### Fushat e vështirësive

Në korniza të fushave, nxënësit me diskalkuli më shpesh i kanë vështirësitë vijuese:

- ▶ **Vëmendja dhe koncentrimi** (funksionet suksesive jo të zhvilluara mirë, vëmendja joselektive dhe afatshkurte)
- ▶ **Perceptimi** (vështirësi në perceptimin hapësinor dhe kohor)
- ▶ **Motorika** (vështirësi gjatë koordinimit, orientimit)
- ▶ **Emocionet dhe raportet sociale** (papjekuri e dëshirës dhe emocioneve, lodhje e shpejtuar energjetike – lodhje e shpejtë, organizim i dobët i dëshirës për aktivitete mentale – kundërshtim ndaj të shkruarit dhe mësimnxënies, humbje e vetëbesimit, pakënaqësi me vetëveten, frustrim)
- ▶ **Funksionet kognitive** (mosorganizim, vështirësi në formimin e koncepteve matematikore, vështirësi në të mbajturit mend afatshkurtë, çrregullim në shkrim dhe lexim dhe operacionet matematikore)

### Qëllimi i përkrahjes individuale

Bashkëpunëtorët profesional duhet ti ndihmojnë fëmijës:

- ▶ Në të kuptuarit e gjuhës matematikore dhe në largimin frikës nga ai (të zbulohet niveli gjuhësor i fëmijës dhe ajo që e shqetëson në gjuhën matematikore);
- ▶ Në të kuptuarit e detyrave problemore (të zbulohet se çka fëmija kupton se çka kërkohet gjatë zgjidhjes së detyrave problemore) dhe lidhja e tyre me situatat e përditëshme jetësore të cilat mund të zgjidhen në mënyra të ndryshme;
- ▶ Gjatë arritjes së automatizuar të operacioneve aritmetike;
- ▶ Të nxitet aftësia e të menduarit vizuel, që do të mundësojë zhvillim të aftësisë për vizuelizim dhe konceptualizim të karakteristikave hapësinore të cilat janë të rëndësishme për shumë koncepte matematikore;
- ▶ Në eliminimin e qëndrimit se matematika është abstrakte dhe mërzitëshme.

### 3.5. Vështirësitë në mësimnxënie të shkaktuara nga aftësitë e zvogëluara intelektuale

Kjo pjesë ka të bën me aftësinë e zvogëluar të fëmijëve të cilët kanë kufizime të rëndësishme në funksionimin intelektual dhe në sjelljen adaptive, e cila shprehet në shkathtësitë konceptuale, sociale, praktike dhe adaptive.

**Funksionimi intelektual** ka të bëjë me intelgjencën – aftësinë mentale gjenerale e cila kyç paragjykime, mendime, përfundime, planifikim, zgjidhje të problemeve, të menduarit abstrakt, të kuptuarit e ideve komplekse, mësimnxënie të shpejtë dhe mësimnxënie me përvojë. Shkalla e funksionimit intelektual më së miri tregohet me ndihmën e IQ –koeficienti i intelgjencës i matur me ndihmën e testeve të standardizuar për intelgjencën.

**Sjellja adaptive** paraqet përmbledhje të shkathtësive konceptuale, sociale dhe praktike të cilat personi i ka mësuar me qëllim të funksionojë në jetën e përditëshme. Kufizimet në sjelljen adaptive ndikojnë në sjelljet tipike, të zakonshme në jetën e përditëshme dhe aftësia për gjendshmëri dhe ndryshimet jetësore dhe kërkesat e mjedisit. Fushat e sjelljes adaptive janë: komunikimi, kujtesa për veten, gjendshmëria në mjedis, vetëorientimi, shëndeti, sigurimi, koha e lirë, puna, jeta në shtëpi dhe dituritë funksionale akademike.

Aftësia e zvogëluar vlerësohet sipas asaj se sa janë zvogëluar aftësitë në raport me nevojat e jetës në tërësi të personit dhe nevoja për përkrahje të individualizuar.

#### Si manifestohet?

Për aftësitë e zvogëluara intelektuale **vështirësi karakterisike dhe specifika** në funksionim në fushat vijuese janë:

**Të folurit** – shqiptim i gabuar i tingujve, fjalor i vobekët

**Të kuptuarit** – vështirësi në lidhshmërinë dhe dhënien e kuptimit pjesëve të ndara të informatave (p.sh. të kuptuarit e rëndësisë së fjalëve, shqyrtimi i shkakut, pasoja)

**Loja** – karakteristike për fëmijët me ritje kronologjike më të vogël

**Motorika** – koordinim i dobët motorik. Lëvizje karaktersistke dhe lëvizje përsëritëse stereotipe

**Sjellja** – koncentrim i dobët, të mbajturit e dobët mend, elemente të hiperaktivitetit, agresiviteti ose apatia

**Shkrimi dhe leximi** – në moshën prej shtatë vjeç fëmija ende ka vështirësi gjatë vizatimit të figurave siç janë rrrathët, katrorët; ka vështirësi gjatë formimit të rradhitësve të thjeshtë, zëvendëson shkronja të ngjashme, ka vështirësi gjatë formimit të vargjeve (fotografive, kartelave...), nuk mund të kujtohet në pesë numra ose fjalë sipas rradhitjes menjëherë pasi që i ka dëgjuar.

#### Fushat e vështirësive

Nxënësit me aftësi intelektuale të ulëta kanë vështirësi në fushat vijuese:

- ▶ **Vëmendja dhe koncentrimi** (vëmendje afatshkurte, e paorganizuar dhe jo selektive)
- ▶ **Perceptimi** (vështirësi në perceptimet hpësinore dhe kohore)
- ▶ **Motorika** (aktivitete të përforcuara psikomotorike, vazhdimisht në lëvizje të cilat nuk janë të koordinuara, përsëritja e lëvizjeve të njejta, kontrollimi i zvogëluar trupor)
- ▶ **Emocionet dhe raportet sociale** (frustrimi nga ndryshimet, papjekuria për dëshirë dhe emocione, vështirësi në realizimin e relacioneve me të tjerët).
- ▶ **Funksionet kognitive** (vështirësi në ruajtjen e të mbajturit mend të përmbajtjeve të mësuara, interesime të ngushta dhe sipërfaqësore, vështirësi në të kuptuarit e asaj që është perceptuar, të menduarit e vështirësuar abstrakt veçanërisht të proceseve të analizës dhe sintezës, vështirësi në shpjegimin e mendimeve me të folurit – të shprehurit gojor dhe me shkrim, vështirësi në të kuptuarit e bashkëbiseduesit, moskritika veçanërisht në ballafaqim me rrëziqet).

### Qëllimi i përkrahjes individuale

Bashkëpunëtorët profesional duhet ti ndihmojnë fëmijës :

- ▶ Të përforcon koordinimin e lëvizjeve
- ▶ Të mundet të ruajë vëmendjen në kohë më të gjatë në një aktivitet
- ▶ Të përmirësojë aftësitë perceptive dhe interpretimin e të perceptuarës
- ▶ Të përmirësojë të kuptuarit
- ▶ Të përmirësojë të shprehurit gojor
- ▶ Të zvogëlojë frustrimin dhe presionin emocional



## PJESA E DYTË:

IDENTIFIKIMI I VËSHTIRËSIVE,  
PLANIFIKIMI DHE EVIDENTIMI  
I PËRKRAHJES INDIVIDUALE

**P**una e ekipit profesional duhet fillimisht të jetë preventive, nëpërmjet të krijimit të mjedisit dhe klimës përkatëse inkluzive në shkollë dhe e orientuar nga të gjithë nxënësit, me gjithë ate nxënësit me vështirësi në mësimnxënie shpesh janë në fokusin e punës së bashkëpunëtorëve profesional. Kur qasjet mësimore të zakonëshme dhe puna e fokusuar e arsimtarëve me grupe të nxënësve me vështirësi nuk janë të mjaftueshme që të sigurojnë përparim përkatës në mësimnxënie te disa nxënës të caktuar, atëherë pritet përkrahje profesionale më e thellë nga bashkëpunëtorët profesional. Nëse arsimtari duhet të dijë ta përshtat mësimin në nevojat individuale të nxënësit, bashkëpunëtori profesional duhet të dijë që ti përforcojë kapacitetet e nxënësit dhe ta përgatit për mësim. Për këte, ekipi i bashkëpunëtorëve profesional, pas observimit të kryer dhe identifikimit të kapaciteteve ekzistuese te fëmija, si dhe në fushat në të cilat paraqiten vështirësitë, duhet të bëjë plan për intrvenim, në të cilin të gjitha aktivitetet do të mendohen mirë, do të rrjedhin në mënyrë të koordinuar dhe në funksion të përmirësimit të gjendjeve, ndërsa me qëllim që nxënësi të përgatitet për mësimnxënie dhe për funksionim më të mirë në jetë, gjatë së cilës me rëndësi të veçantë është intervenimi i hershëm.

Në rast se për nxënësin përgatitet plan individual arsimor (PIA) aktivitetet e bashkëpunëtorëve profesional duhet të planifikohen si pjesë e PIA –së.

Të gjitha aktivitetet të cilat janë planifikuar dhe realizuar që më parë është e nevojshme të evidentohen, gjatë së cilës është shumë me rëndësi që të bëhet refleksioni i detajuar i secilit aktivitet të realizuar. Kjo do të thotë të shënohet se çka është bërë dhe si është bërë, me çfarë qëllimi, të përshkruhet në mënyrë të detajuar sjellja e nxënësit, të gjithë atë që ka bërë gjatë aktivitetit dhe ate që ka biseduar, vështirësitë të cilat i ka hasur, sukseset të cilat i ka arritur, bile edhe atëherë kur ata suksese janë vetëm një hap i vogël. E gjithë kjo do të shërbejë:

- të gjithë anëtarët e ekipit ta kenë të qartë se çka është punuar dhe deri ku është arritur;
- të ndiqet përparimi i nxënësit dhe në bazë të saj të planifikohen të gjitha interevenimet vijuese;
- të informohen prindët për ate se çka është punuar dhe çka është arritur si dhe t'ju jepen udhëzime për ate se si duhet ata të vazhdojnë me punën me fëmijën në shtëpi;
- në disa raste, kur njëri nga faktorët për paraqitjen e vështirësive është vetë prindi, të organizohet dhe realizohet edukim dhe përkrahje prindore;
- të bëhet lidhja dhe koordinim i aktiviteve të cilat i realizojnë bashkëpunëtorët profesional me aktivitetet në klasë të cilat i realizojnë arsimtarët..

## 1 | IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI FILLESTAR

Identifikimi i aftësive dhe nevojave të nxënësit kryhet më shumë herë gjatë shkollimit, veçanërisht gjatë regjistrimit të nxënësit dhe më vonë nëse ballafaqohet me vështirësi në mësim.

**Vlerësimi fillestar** zakonisht realizohet në fillim të vitit shkollor dhe paraqet përshkrim të potencialëve dhe nevojave të nxënësit. Gjatë kësaj është me rëndësi që të vërtetohen aftësitë (çka mund të bën nxënësi), interesimet (çka dëshiron të bëjë nxënësi) dhe nevojat (çka i nevojitet nxënësit si përkrahje. Kur është në pyetje nxënësi me vështirësi në mësimnxënie kohë pas kohe bëhet revizion i vlerësimit (vlerësim i sërishëm) me qëllim që më mirë të planifikohen aktivitetet vijuese.

Identifikimi i vlerësimit të aftësive dhe nevojave bëhet në disa mënyra dhe në bazë të të dhënave të fituara nga më shumë burime.

### **Përgatitja për vlerësim:**

Përgatitja për vlerësim: vështirim në dokumentacionin dhe të dhënat ekzistuese (vlerësimi i mëparshëm, rezultate ose gjetje si dhe mendime, aftësi dhe nevoja të fëmijës).

### **Burimi:**

Prindi, arsimtari, observimi, rezultatet nga hulumtimet me instrumente për vlerësim objektiv

**Observimi** është metodë e ndjekjes së strukturuar dhe të shënuarit të sjelljes së nxënësit gjatë kohës së punës në orë, gjatë kohës së pushimit, aktiviteteve të lira dhe lojës me nxënësit të tjerë. Qëllimi i observimit është që më mirë të njihemi me nxënësi nëpërmjet njohjes së potencialeve të tija, aftësive dhe kufizimeve për ta përshtatur mësimdhënien dhe përkrahjen individuale në nevojat e tija.

**Instrumentet për vlerësim objektiv** janë: testet e intelegjencës, testet e aftësive sepcifike, shkalla e vlerësimit, pyetësorët, inventarët e personalitetit, inventarët e shprehive punuese, qëndrimet, etj.

Informatat e fituara nëpërmjet të identifikimit dhe verësimit nga burime të ndryshme janë bazë që i ndihmojnë arsimtarit në planifikimin e punës dhe përshtatjen e procesit mësimor për nevojat individuale të nxënësit, si dhe bashkëpunëtorëve profesional për planifikimin e përkrahjes individuale të cilën duhet ta japin.

## 2 | PLANIFIKIMI

### 2.1. Modeli i Planit për ekipin e bashkëpunëtorëve profesional për përkrahje individuale nxënësve me vështirësi në mësimnxënie

Ky plan përgatitet nga ekipi i bashkëpunëtorëve profesional dhe shërben që të bëhet lidhshmëria e profilit të nxënësit e fituar nëpërmjet observimit dhe informatave të fituara nga prindët, arsimtari dhe vetë nxënësi me intervenimet të cilat duhet të vijojnë.

Emri dhe mbiemri i nxënësit:		Datëlindja:		Klasa:
Fusha	Anët e forta	Nevojat	Kush do të japë përkrahje individuale	Në cilën periudhë
Vëmendja dhe koncentrimi				
Perceptimet				
Të mbajturit mend				
Motorika				
Funksionimi kognitiv				
Sjellja/pavarësia				
Funksionimi socio-emocional				
Të arriturat akademike				
<b>Qëllime të lidhura me nevojat e identifikuara që më parë:</b>				
<b>Startegji të lidhura me qëllimet e parashtruara (cilat intervenime, aktivitete, strategji, mundet ta përmirësojnë funksionimin?):</b>				
<b>Të dhëna të fituara për të ariturat (çka është aritur? Sa kanë qenë të dobishme intervenimet? Si munden qëllimet, strategjitë dhe inetrvenimet të përmirësohen për tu fituar rezultate më të mira?):</b>				
<b>Revizioni i planit</b>				

## 2.2. Modeli i Planit të bashkëpunëtorit profesional për prkohje individuale të nxënësve me vështirësi në mësim

Planin e përgatit bashkëpunëtori profesional në bazë të *Planit të ekipit të bashkëpunëtorëve profesional për prkohje individuale të nxënësve me vështirësi në mësim*.

<b>Emri dhe mbiemri i nxënësit:</b>		<b>Datëlindja:</b>		<b>Klasa:</b>
<b>Fushat kyçe në të cilat do të intervenohet</b>				
<b>Strategji dhe aktivitete</b>	<b>Qëllimi i aktivitetit</b>	<b>Materiale për punë</b>	<b>Koha e realizmit</b>	<b>Fusha tjera në të cilat mund të intervenohet me aktivitetin</b>
<b>Bashkëpunëtori profesional:</b>				



## 3 | EVIDENCA

### 3.1. Model i Formularit për evidencën e përkrahjes së realizuar individuale

Në këtë formular bashkëpunëtori profesional i shënon aktivitetet e realizuara për përkrahje individuale.

<b>Emri dhe mbiemri i nxënësit:</b>		<b>Datëlindja:</b>	<b>Klasa:</b>
<b>Fusha në të cilat është intervenuar dhe përshkrim i nevojave nga përkrahja</b>			
<b>Aktiviteti i realizuar</b>	<b>Data e realizimit</b>	<b>Refleksion nga aktiviteti i realizuar</b>	<b>Çka është aritur</b>
<b>Bashkëpunëtori profesional:</b>			

### 3.2. Model i Formularit për evidencë të ushtrimeve të realizuara për memorim

Në këtë formular bashkëpunëtori profesional i shënon të ariturat e nxënësit gjatë ushtrimit nëpërmjet të shënimit të fjalëve të mbajtura mend gjatë secilit tentim.

Ushtrimi i memorimit		
Nxënësi: _____		
<b>Elementet të cilat nxënësi duhet ti mban mend</b>		
Numri i tentimeve		
Tentimi 1	Tentimi ____	Tentimi ____
<b>Elementet e mbajtura mend</b>	<b>Elementet e mbajtura mend</b>	<b>Elementet e mbajtura mend</b>
Tentimi ____	Tentimi ____	Tentimi ____
<b>Elementet e mbajtura mend</b>	<b>Elementet e mbajtura mend</b>	<b>Elementet e mbajtura mend</b>

## PJESA E TRETË: STRATEGJI, MËNYRA DHE SHEMBUJ TË MATERIALEVE PËR PÛRKRAHJE INDIVIDUALE

**G**ajtë zgjedhjes së mënyrave më përkatëse për punë, intervenime ose qasje ndihmëse në përkrahjen individuale të nxënësve me vështirësi në mësimnxënie, bashkëpunëtorët profesional duhet të bazohen në të gjitha informatat qasëse, të provojnë strategji të ndryshme dhe me vëmendje të kryejnë monitorim ndaj efekteve. Në atë mënyrë do të mundën ti zgjedhin strategjitë më përkatëse për nxënësin konkret, pse nxënësi me vështirësinë në mësimnxënie sillen dhe reagojnë në mënyrë të ndryshme kur punohet për ata, gjegjësisht nuk ekzistojnë dy nga ata të cilët saktësisht në mënyrë të njejtë do të përgjigjen në një aktivitet të njejtë.

Me rëndësi është që të kuptohet se një strategji e njejtë nuk do të thotë se do të zgjidh nevojat e të gjithë nxënësve me vështirësi të caktuara në mësimnxënie si dhe secilit nxënës edhe pse vështirësitë e tija i takojnë një grupi të caktuar me pengesa ose janë shkaktuar nga faktorë të caktuar social, ekonomik dhe kulturorë, paraqet tregim ndryshe dhe kërkon qasje specifike të individualizuar. Për ate, intervenimet e para gjithmonë duhet të bëjnë me adaptimin dhe vendosjen e relacioneve të mira ndërmjet bashkëpunëtorit profesional dhe nxënësit, me çka zvogëlohet frika, shqetësimi dhe pasiguria të nxënësi, ndërsa krijohet një klimë përkrahëse e bazuar në besim.

Në fillim të përkrahjes individuale është mirë që gjithmonë të fillohet me ate se çka të nxënësi paraqet anë e fortë dhe të bëhet lidhshmëria me vështirësinë të cilën e ka nxënësi.

### Si për shembull:

**nxënësi mundet të vizatojë mirë, por ka vështirësi me vëmendjen dhe koncentrimin, për ate në fillim do të zgjedhen ushtrime për përkrahje dhe përforsim të koncentrimin të cilat zhvillohen nëpërmjet të vizatimit.**

Në këtë mënyrë do të punohet në llojin e vështirësisë por nxënësi në fillim nuk do të ballafaqohet me mospësuks. Në këtë mënyrë njëkohësisht punohet në më shumë pika të intervenimit: koncentrimi dhe vëmendja, komponenta emocionale, motivimi.

Përkrahja individuale duhet të bazohet në psikologjinë pozitive, e cila nënkupton zhvillim të anëve të forta të nxënësit, kundrejt "përmirësimit të mangësive", gjegjësisht në krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillim, vetërealizim dhe socializim të nxënësit, gjegjësisht të kushteve për përkrahje me ndihmën e të cilave çdo nxënës mund të përjetojë sukses.

Në këtë pjesë të doracakut janë përshkruar aktivitete, ushtrime dhe materiale të cilat mundet të shfrytëzohen gjatë përkrahjes individuale që janë grupuar në korniza të fushave vijuese në të cilat paraqiten vështirësi:

1. Emocionet dhe raporte sociale
2. Vëmendja dhe koncentrimi
3. Perceptimet dhe të mbajturit mend
4. Motorika
5. Zhvillimi i të folurit
6. Zhvillimi i leximit
7. Zhvillimi i aftësive matematikore

Ushtrimet e ofruara, aktivitetet ose materialet nuk munden (dhe nuk duhet) të kufizohen reptësisht në përkrahjen e zhvillimit të vetëm një aftësie. Si për shembull, ushtrime dhe materiale të caktuara mund të shfrytëzohen për nxitjen e zhvillimit emocional, por edhe të ndikojnë në zhvillimin e perceptimeve dhe të mbajturit mend, si dhe ndaj zhvillimit të të folurit dhe pasurimit të fjalorit (p.sh. kartelat e emocioneve). Për këtë shkak, zgjedhja duhet të planifikohet mirë dhe të bazohet në vlerësimet e kryera që më parë në raport me funksionet të cilat duhet të përforcohen dhe atyre të cilat duhet të formohen dhe të zhvillohen.

Varësisht nga nevojat e nxënësve të cilëve do t'ju jepet përkrahja direkte dhe nga lloji i aktivitetit, mund të punohet me nxënës në mënyrë individuale ose me grup të nxënësve, mirëpo gjithmonë puna duhet të fokusohet në nevojat individuale të nxënësit.

Numri më i madh i shembujve të treguar të aktiviteteve janë përkatëse për punën me fëmijën nga mosha më e vogël, fillimisht për shkak se vështirësitë në mësimnxënie duhet të identifikohen sa që është e mundur më herët dhe me tejkalimin e tyre të fillohet që nga vitet e para të shkollimit. Numër i madh i aktiviteteve mundet ti shfrytëzojnë edhe arsimtarët, por do të ishte mirë me ata të fillojnë bashkëpunëtori profesional nëpërmjet përkrahjes individuale ndërsa arsimtarët të vazhdojnë ti shfrytëzojnë si aktivitete individuale ose grupe.

### 3.1. Emocione dhe raporte sociale

Emocionet paraqesin gjendje shqetësimi në organizëm të shkaktuara nga stimulues (situata) të rëndësishme me rëndësi subjektive të cilën në mënyrë fiziologjike, motorike, motivuese dhe mentale e përgatit personin për aktivitete adaptues, ata janë reaksione të zgjeruara kognitivo – fiziologjike – bihevi-orale të cilat kanë funksion të dyfishtë.

Fëmijët me vështirësi specifike në mësimnxënie janë në rrezik më të madh të zhvillojnë:

- Pasqyrë negative për veten (se nuk janë mjaft të aftë, të mençur, të shkathtë)
- Motivimi i dobët për mësimnxënie
- Mosndihma e mësuar (që më parë, para se të tentojnë, mendojnë se nuk munden, nuk dijnë ...)
- Anksioziteti (shqëtsimi, sikleti, nuk ndjehet mirë)
- Depresioni (jomotivim, i tërhijekur, i vetmuar).

## Pse është kështu?

Shumë shpesh, nxënësit me vështirësi në mësimnxënie nuk kanë pengesa të dukshme, siç janë pengesat motorike ose pengesa lidhur me të pamurit, dëgjimin, prandaj edhe mossa e tyre deri sa saktësisht të detektohet shkaku i cili shkakton vështirësi, logaritet si produkt i përtacisë së fëmijës, papërgjegjësisë së tij, angazhimit jo të mjaftueshëm, etj. Fëmijës i parashtrihen kërkesa të cilat në realitet ai nuk është në gjendje ti arrijë, prandaj edhe pse jep mjaft mund vazhdimisht përjeton mossa dhe në vend të lëvdatave më shpesh fiton kritika.

Numri më i madh i nxënësve të cilët kanë vështirësi në mësimnxënie kanë emocione e cënueshme të cilat gjithashtu ndikojnë në mësimnxënies. Këta emocione dalin nga shkaqe të ndryshme siç janë: frustracionet lidhur me vështirësitë e tyre, ndjenja për mospërfshirje ose ngecje kur krahasohen me moshatarët e tyre, nervoza dhe probleme me vetëbesimin kur shohin se ngadalë përparojnë, shqetësim, turpërim kur japin përgjigje të gabuar ose marrin notë të ulët, anksozitet i cili del nga fokusimi për shkak të vështirësive të tyre, ndenjës për padrejtësi kur nuk i vërejnë ose nuk i përkëdhelin anët e tyre të forta.

## Shembuj të aktiviteteve dhe materialeve për përkrahje individuale

Fëmijët i mësojnë emocionet nga përvojat. Reagimi emocional është shpesh i lidhur edhe me kulturën e të jetuarit. Disa emocione fëmijët nuk i shohin, por me rëndësi është të mësojnë se edhe ata ekzistojnë.

Kontaktet e para dhe hapja e fëmijës për ti identifikuar dhe treguar emocionet e veta zhvillohet nëpërmjet lojës, shpesh me ndihmën e materialeve të ndryshme ndihmëse (kartelave, kukullave, topave) me ndihmën e të cilave janë shprehur emocione të ndryshme, tërbim, mallëngjim, gëzim, frikë, dhembje... Në këtë mënyrë, duke e udhëhequr fëmijën nëpër lojërat e këtilla e mësojmë që ti identifikon emocionet, ti din shkaqet për paraqitjen e tyre, të mundet ti tregon emocionet e veta, por në të njëjtën kohë ndikojmë edhe në fusha të tjera të ndryshme, si për shembull në fushën e zhvillimit socio-emocional. Kështu, nëpërmjet të lojës fëmijën e mësojmë të vendos kontakte me të tjerët të bazuar në tolerancë dhe në miqësi si në disa situata të stresit mundet të zgjidhen pa tërbim dhe dhunë, si ta shpërndajnë gëzimin, por edhe mallëngjimin. Në të njëjtën kohë, shumë emocione të fshehura shumë shpejt fëmija do ti ndajë me kukullën se sa me dikënd tjetër, kurse ne do të kemi pasqyrë për ate se çka ndodh në shpirtin e ti dhe do të mundemi intervenimet tona në mënyrë të drejtë ti orientojmë. Loja është mundësi e mirë të intervenohet në zhvillimin e kujdesit për veten- zhvillimin e shprehive higjienike dhe kulturore, mësimin e rregullave, zhvillimin e pasqyrës për vete, nxitjen e pavarësisht dhe forcimin e vetëbesimit.

Aktivitetet tjetër i cili dukshëm ndihmon për zvogëlimin e vështirësive psiko-fizike dhe emocionale është "art trajtimi", që paraqet aktivitetet krativ dhe ekspresiv të bazuar në kombinimin e lojës, të vizatuarit, muzikës, ngjyrës dhe fotografisë. Punëtoritë psikologjike, të cilat janë pjesë nga praktika e bashkëpunëtorëve profesional, janë gjithashtu të rëndësishme, veçanërisht në domenin e zhvillimit të raporteve sociale, raportin ndaj vetes, kujdesin për vetëveten dhe relacionet me të tjerët.

Emocione<sup>14</sup>

## Aktiviteti 1

## KUBI ME PERSONAZHE

**Përshkrimi** Kub i butë nga tekstili me dimensione 20X20. Në secilën faqe ka fytyrë me shprehje të ndryshme emocionale.

## Fusha për intervenime

**1. Zhvillimi socio - emocional.** Është mundur që fëmija të përparojë nëpër faza të ndryshme të interaksionit social dhe të përvetëson shkathtësi për kontakte me të tjerët, bashkëpunim, shkëmbim. Mëson që ti kontrollojë dhe të respektojë emocionet e veta dhe të tjerëve.

**2. Gjuha dhe të folurit.** Ndhmon për zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit, komunikimit dhe leximit, si dhe për të shprehurit e ndjenjave, dëshirave dhe nevojave të veta.

## Shembull për punë individuale

Hudhet kubi dhe bosedohet për emocionin i cili është në anën e sipërme të kubit (për atë se si është e shprehur nëpërmjet fytyrës; si ndjehet fëmija kur është p.sh. i mërziur, i hidhëruar, i gëzuar; kur ndjehet ashtu; çka bën atëherë, etj.), me çka veprohet në fushën e zhvillimit emocional dhe njëkohësisht nxitet të folurit dhe komunikimi.



## Aktiviteti 2

## MASKA EMOCIONE TË ARUSHËZAVE

**Përshkrimi** 6 maska me shkopiinj me shprehje të ndryshme emocionale.

## Fusha për intervenime

**1. Zhvillimi socio - emocional.** Është mundur që fëmija të përparojë nëpër faza të ndryshme të interaksionit social dhe të përvetëson shkathtësi për kontakte me të tjerët, bashkëpunim, shkëmbim. Mëson që ti kontrollojë dhe të respektojë emocionet e veta dhe të tjerëve.

**2. Gjuha dhe të folurit.** Ndhmon për zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit, komunikimit dhe leximit, si dhe për të shprehurit e ndjenjave, dëshirave dhe nevojave të veta.

## Shembull për punë individuale

Në pyetjen “si ndjehesh sot?” fëmija duhet ta afron maskën përkatëse afër fytyrës. Fillohet bisedë me atë emocion, çka ka ngjarë, çka bën kur ndjehet ashtu, a ndjehet njëllë gjithmonë kur ndjehet sikurse sot, çka bëjnë të tjerët kur ndjehet si sot, etj.



14 Një pjesë e materialeve janë adaptuar sipas <http://www.idadidacta.hr/emocije-to12>

## Aktiviteti 3

## KUKULLA EMOCIONESH

**Përshkrimi** 8 kukulla nga materiali i butë me shprehje të ndryshme emocionale

**Fusha për intervenime**

- 1. Perceptimi vizuel** gjegjësisht mundësia për interpretim të informatave të pranuar nëpërmjet syrit. Ndihmon që fëmijojë të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).
- 2. Zhvillimi socio - emocional.** Është mundësuar që fëmija të përparojë nëpër faza të ndryshme të interaksionit social dhe të përvetëson shkathtësi për kontakte me të tjerët, bashkëpunim, shkëmbim. Mëson që ti kontrollojë dhe të respektojë emocionet e veta dhe të tjerëve.
- 3. Gjuha dhe të folurit.** Ndihmon për zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit, komunikimit dhe leximit, si dhe për të shprehurit e ndjenjave, dëshirave dhe nevojave të veta.

**Shembull për punë individuale**

- Janë të përshtatshme për punë me fëmijë më të vegjël, veçanërisht për të filluar bisedën për emocionet (emërimi i emocioneve, çka bën kukulla, çka bën ti kur ndjehesh si kukulla, etj.) Gjatë së cilës nxitet të shprehurit verbal.
- Duke patur parasyshë koloritin e kukullave mund të bisedoet edhe për ngjyra, madhësitë, vendosjen e kukullave në hapësirë (mbi, nën, para, pas, lartë, poshtë, etj.) me çka ushtrohet perceptimi vizuel i orientimit në hapësirë.



**Shembull për punë në grupe**

Loja e roleve, loja simbolike me qëllime të ndryshme: të shprehurit e emocioneve; të kuptuarit e të tjerëve, vendosja e kontakteve, bashkëpunimi, sjellja jo e dhunëshme etj. Lojërat mund të fillojnë si pjesë e punës individuale (bashkëpunëtori profesional – fëmija), Nërsa pastaj rë vazhdojnë nëpërmjet punës grupore (fëmija - fëmijët tjerë).

## Aktiviteti 4

## TOPA EMOCIONESH

**Përshkrimi** 6 topa gome me shprehje të emocioneve të ndryshme.

## Fusha për intervenime

- 1. Motorika e madhe** – lëvizje (ecje, vrapim, kërcim, rikërcim), mbajtja e baraspeshës (mbajtja e kokës, të lakuarit, shtrydhje, rrotullim), vrepimi me gjësende (hudhje, kapja, të mëshuarit, rënia)
- 2. Koordinimi sy – dorë** – kontrollim i koordinuar i lëvizjes së syve me lëvizjen e dorës.
- 3. Gjuha dhe të folurit.** Ndhmon për zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit, komunikimit dhe leximit, si dhe për të shprehurit e ndjenjave, dëshirave dhe nevojave të veta.

## Shembull për punë individuale

Lojëra për hudhje kapje, gjatë së cilës bisedohet për emocionet e paraqitura në topat me të cilat lozet.



## Aktiviteti 5

## RRADHITËSI TË SHPREHURIT E FYTYRËS

**Përshkrimi** Pllakë druri me 25 pllakëza druri për vendosje. Në secilën anë ka fytyrë me shprehje të ndryshme emocionale.

## Fusha për intervenime

- 1. Perceptimi vizuel** gjgjësisht mundësia për interpretim të informatave të pranuar nëpërmjet syrit. Ndhmon që fëmijoa të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).
- 2. Zhvillimi socio - emocional.** Është mundësuar që fëmija të përparojë nëpër faza të ndryshme të interaksionit social dhe të përvetëson shkathtësi për kontakte me të tjerët, bashkëpunim, shkëmbim. Mëson që ti kontrollojë dhe të respektojë emocionet e veta dhe të tjerëve.
- 3. Përfundimi logjik** – zhvillimi i të menduarit dhe paragjykimi me qëllim të zgjidhjes së situatave problemore të cilat kycin lidhshmërinë e ndërsjelltë të informatave.
- 4. Gjuha dhe të folurit.** Ndhmon për zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit, komunikimit dhe leximit, si dhe për të shprehurit e ndjenjave, dëshirave dhe nevojave të veta.

## Shembull për punë individuale

Shprehjet e fytyrave duhet t'ju shoqërohen fytyrave, duke i kombinuar informatat nga rradhët më lartë dhe kolonat nga ana. Në këtë mënyrë përforcohet perceptimi vizuel dhe koncentrimi.

Deri sa rradhiten shprehjet bisedohet për secilën nga emocionet, për atë se si jaën shprehur nëpërmjet fytyrës, si ndjehemi p.sh. kur jemi të mërzhitur, hidhëruar, gëzuar kur ndjehemi ashtu, çka bëjmë atëherë, etj.





## Aktiviteti 6

## KARTELAT E EMOCIONEVE

**Përshkrimi** Komplet i 40 kartelave me fytyra të shprehjeve të ndryshme emocionale

**Fusha për intervenime**

- 1. Perceptimi vizuel dhe të mabjturit** mend gjegjësisht mundësia për interpretim të informatave të pranuar nëpërmjet syrit. Ndhmon që fëmioja të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).
- 2. Zhvillimi socio - emocional.** Është mundësuar që fëmija të përparojë nëpër faza të ndryshme të interaksionit social dhe të përvetëson shkathtësi për kontakte me të tjerët, bashkëpunim, shkëmbim. Mëson që ti kontrollojë dhe të respektojë emocionet e veta dhe të tjerëve.
- 3. Gjuha dhe të folurit.** Ndhmon për zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit, komunikimit dhe leximit, si dhe për të shprehurit e ndjenjave, dëshirave dhe nevojave të veta.



**Shembull për punë individuale**

1.Fëmijës i tregohen kartelë pas kartelev dhe nga ai kërkohet ta emëron emocionin të cilin e vëren ose i tregohet një kartele dhe kërkohet nga ai të tregohet se çka sheh. Plotësisht mund të parashtrihen pyetje në lidhje me ngjyrat, format, elementet, perceptimet hapësinore. Në këtë mënyrë nxitet të folurit dhe komunikimi dhe përforcohet perceptimi vizuel.

2.Fëmijës i vëndohen në tavolinë të gjitha kartelet dhe kërkohet ti bën në çifte shprehjet e kundërta të fytyrave , si p.sh. gëzimi dhe mallëngjimi, të menduarit dhe gjendja e qetë. Në këtë mënyrë kartelat shfrytëzohen si memorime kundër thënësë. Deri sa zhvillohet ky aktivitet mund të fillohet biseda për ate se kur fëmija është i gëzuar, a kurë i mërzitur, pse, çka bën atëherë, etj. Me çka veprohet në fushën e zhvillimit emocional.



## Aktiviteti 7

## TË VIZATUARIT DHE NGJYROSJA

**Përshkrimi** Bllok komplet me fleta të bardha ose fleta të bardha A4, komplet me të gjitha ngjyrat – të drurit, tempera, akuairel, ose flomasterë, laps, brushë, gotë me ujë, paletë për përzierjen e ngjyrave, prerëse dhe gomë.

## Fusha për intervenime

- 1. Zhvillimi socio - emocional.** Është mundësuar që fëmija të përparojë nëpër faza të ndryshme të interaksionit social dhe të përvetëson shkathtësi për kontakte me të tjerët, bashkëpunim, shkëmbim. Mëson që ti kontrollojë dhe të respektojë emocionet e veta dhe të tjerëve.
- 2. Motorikae vogël** – kontrollim i koordinuar i lëvizjes së syve me lëvizjen e dorës.
- 3. Perceptimi vizuel** dhe të mabjturit mend gjegjësisht mundësia për interpretim të informatave të pranuar nëpërmjet syrit. Ndhmon që fëmioja të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).
- 4. Gjuha dhe të folurit.** Ndhmon për zhvillimin e shkathtësive të të dëgjuarit, komunikimit dhe leximit, si dhe për të shprehurit e ndjenjave, dëshirave dhe nevojave të veta.

## Shembull për punë individuale

Ky aktivitet mund të shfrytëzohet më shumë herë me dinamikën vijuese:


- Vizatim sipas dëshirës vetanake
- Vizatim UNË
- Vizatim me Familja ime
- Vizatim Unë me shokët/shoqet e mi
- Vizatim Kur isha jo e/i lumtur
- Vizatim Kur isha i/e lumtur

Deri sa fëmija vizaton bisedohet në lidhje me atë se çka vizatojë.



## Vetëbesimi dhe raportet sociale<sup>15</sup>

### Aktiviteti 1

ÇKA MË PËLQEN NË VEHTEN TIME	
<b>Përshkrimi</b>	Fletë pune
<b>Fusha për intervenime</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi i vetëbesimit – shqyrtimi i anëve të forta vetanake</li> <li>2. Gjuha dhe të folurit – pasurimi i fjalorit</li> </ol>
<b>Shembull për punë individuale</b>	<p>Fëmija nxitet:            Që ta shkruajë emrin e vet në mes të lules.            Në Çdo petal (fletë) të lules të shënohet diçka që pëlqen te ai.            Bisedohet për ste se çka i pëlqen dhe pse pikërisht ajo i pëlqen.</p> 

### Aktiviteti 2

DRURI I DËSHIRAVE	
<b>Përshkrimi</b>	Dru i vizatuar në hamer, lule shumëngjyrëshe dhe gjethe të punuara nga letra me ngjyra
<b>Fusha për intervenime</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi i raporteve sociale – sjellje bashkëpunuese</li> <li>2. Gjuha dhe të folurit – pasurimi i fjalorit</li> </ol>
<b>Shembull për punë grupore</b>	<p><b>Fëmijëve ju jepen udhëzimet vijuese:</b>            “Secili nga ne ka nga një dëshirë shumë të madhe. Shënoni dhëshirën tuaj në lule dhe ngjitni ate në degë të drurit.            Kush mund t’ju nidh,ojë që t’ju plotësohet dëshira?            Shënoni në rrënjën e të njejtit dru dhe përforconi ndër trungun e tij për ta ushqyer ate.            Kush ose çka pengon për t’ju plotësuar dëshira.            Shënoni në gjethe dhe vëndoni në dru.”  <b>Lexohen dëshirat, bisedohet për ate se si secili vetë mund të ndikojë që ti plotësohet dëshira, por edhe si të tjerët mund të ndihmojnë për tu plotësuar dëshira.</b></p> 

<sup>15</sup> Adaptuar sipas: Игром до школе: приручник за водитеље играоница са дјецом из социјално депривираних средина: искуства из праксе/ припремила М.Маркочиќ, Удружење дјеца прва, Загреб, 2004 и Weidinger W., Improve your self-esteem and work together – ages 10-12, Zurich University of Teacher Education, Centre IPE, 2015

## Aktiviteti 3

ÇKA MUND TË BËJ ME DHE PËR MIQTË E MIJ			
<b>Përshkrimi</b> Fletë pune			
<b>Fusha për intervenime</b>			
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi i raporteve sociale – sjellje bashkëpunuese</li> <li>2. Gjuha dhe të folurit – pasurimi i fjalorit</li> </ol>			
3 gjëra që dëshiron ti bësh me shokët e tu	3 gjëra që shokët e tu dëshirojnë ti bëjnë sëbashku me ty	3 mënyra me të cilat mundet ti ndihmosh të tjerët	3 mënyra me të cilat shokët e tu munden të të ndihmojnë
<b>Shembull për punë individuale</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fëmija nxitet të përgjigjet në fletat e kërkesës së punës – <b>Thuaj ose trego</b> .....</li> <li>- Bisedohet për ate se çka bën ajo dhe si ju ndihmon shokëve të vet dhe çka bëjnë ata dhe si i ndihmojnë atij;</li> <li>- Udhëhiqet drejt asaj që të nxirret përfundim pse është e nevojshme që të ndihmohen njerëzit.</li> </ul>			

## Aktiviteti 4

FAMILJA IME DHE TRADITAT TONA DALLOHEN	
<b>Përshkrimi</b> Punëtori me grup nxënësish	
<b>Fusha për intervenime</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillimi i raporteve sociale – sjellje bashkëpunuese</li> <li>2. Gjuha dhe të folurit – pasurimi i fjalorit</li> </ol>	
<b>Shembull për punë grupore</b>	
<p>Bashkëpunëtori profesional tregon diçka për veten dhe familjen e tij.</p> <p>Pastaj nxiten fëmijët që secili ta përshkruan familjen e vet, kushtet të në të cilat jeton, përkëdhelësit shtëpiak, bimët ose kafshët për të cilat pëkujdesen në rast se kanë.</p> <p>Përmenden dallimet në familjet në raport me fenë, nacionalitetin dhe kulturën, çka është e përbashkët e çka është e ndryshme në traditat, kremtimin e festave gjuha me të cilën flitet në shtëpi, këngët, etj.</p> <p>Nxënësit udhëhiqen nga nxjerja e përfundimit për ate se pse është me rëndësi që të respektohen dallimet.</p>	

## Aktiviteti 5

RREGULLAT JANË TË RËNDËSISHME	
<b>Përshkrimi</b> Fletë pune	
<b>Fusha për intervenime</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vëndosja e rregullave për sjellje dhe shprehi pune</li> <li>2. Gjuha dhe të folurit – pasurimi i fjalorit</li> </ol>	
<p>The diagram consists of ten ovals arranged in a circular pattern, each containing a behavioral rule. The ovals are colored as follows: blue, orange, red, green, and grey.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Për ta respektuar secilin</li> <li>Për tu bërë nxënës i mirë</li> <li>Për t'ju shangur konflikteve</li> <li>Për të fituar gjithmonë</li> <li>Që ti pëlqejë arsimtarit</li> <li>Për ta ruajtur klasën e pastër</li> <li>Për të mundësuar secilit të bën çka të don</li> <li>Për të lejuar secili të marr pjesë</li> <li>Për mos të sulmuar askush</li> <li>Për të mos ardhur rregullisht në shkollë</li> </ul>	
<b>Shembull për punë individuale</b>	
<p><b>Nxënësit i jepet udhëzimi vijues:</b>  “Kur jetojmë dhe ounojmë sëbashku na nevojiten rregullat për t'ju shmangur shumë konflikteve dhe problemeve. Me rëndësi është që të gjithë ti dijmë ata rregulla dhe ti respektojmë. Ka disa shkaqe pse ata rregulla janë të rëndësishme. Gjeni dhe shënoni ata të vërtetat.”</p> <p><b>Bisedohet për secilin nga shkaqet dhe për ate se pse të shënuarat janë ata të vërtetat.</b></p>	

## Aktiviteti 6

## SI TË THUHET JO

**Përshkrimi** Fotografi me: njerëz, gjësende, kafshë... të ndryshme

**Fusha për intervenime**

1. Kujdesi për vehten dhe sigurinë personale – njohja e rrezikut dhe shmangia nga rreziku
2. Gjuha dhe të folurit – pasurimi i fjalorit

**Shembuj për punë individuale (ose grupe)**

Fëmija e shqyrton materialin me fotografi. Nga fotografitë formohet tregim. Bashkëpunëtori profesional fillon dhe e udhëheq fëmijën nëpër aktivitet.

Shembull:

“-Fëmija lozën në rrugë. Vin një njeri i panjohur, i jep fëmijës çokolatë, pastaj e thëret që të hyp në automobil dhe me forcë e tërhiqet brenda. A ka këtu rrezik? Çfarë? Çka duhet të bëhet? Pse? Cilin mundesh ta thërrasësh nëse gjendesh në situatë të ngjashme?”

Nxënësit nxiten për të propozuar zgjidhjes gjatë së cilës kur bëhet fjalë për punë grupe nxiten në atë mënyrë që secili ta dëgjon njëri tjetrin.



### 3.2. Vëmendja dhe koncentrimi















**Vëmendja** paraqet funksion psikologjik për orientim, për mbajtje të energjisë psiqike të përmbajtjes së zgjedhur. Në vitet e para të jetës fokusimi i vëmendjes është i orientuar nga stimulimi i cili është në funksion të kënaqjes të nevojave të ndryshme të fëmijës. Diku nga mosha dhjetë vjeçare zhvillohet aftësia për mbajtjen më të gjatë të vëmendjes në ndonjë lëndë interesi, ndërsa në adoleshencë vëmendja e arrin nivelin e saj të vërtetë. Ndonjëherë, për shkak të ndikimit të faktorëve të caktuar, nuk vjen deri në zhvillimin e kompletuar të vëmendjes që shkakton paraqitjen e çregullimeve të caktuara të cilat e përcjellin këtë mungesë.

**Selektimi i vëmendjes** paraqet orientim të vëmendjes të atyre vetive të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilët nuk janë të rëndësishëm. Ky aspekt i vëmendjes është me rëndësi në procesin e mësimdhënies gjatë selektimit të asaj se cilët informatat janë të rëndësishme për ti mbajtur mend dhe cilat jo. Te fëmijët me vështirësi në mësimnxënie ky aspekt i vëmendjes duhet vazhdimisht të nxitet (si p.sh. të përmendurit me ndihmën e mjeteve vizuale – të nënvizohet me laps me ngjyrë ajo se çka është me rëndësi të mësohet)

**Koncentrimi** paraqet aftësi që vëmendja në periudhë në të gjatë kohore pa ndërprerje të orinetohet në një detyrë, mendim ose gjësend, duke kyçur gjërat e tjera. Mundësia për koncentrim në aktivitetet të cila ti realizojmë ndikon që ti bëjmë më së miri, më shpejt dhe në mënyrë më të suksesshme. Koncentrimi i mirë e lehtëson mësimnxënien dhe e përmirëson të mbajturit mend dhe të kuptuarit.

## Shembuj të aktiviteteve dhe materialve për përkrahje individuale

### Aktiviteti 1

USHTRIME PËR ZHVILLIMIN E RITMIT									
<b>Përshkrimi</b> Vargje nga format, numrat, shkronjat, gjësendet									
<b>Fusha për intervenime</b>									
<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Koncentrimi dhe vëmendja</b> – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilët janë me rëndësi.</li> <li><b>Perceptimi vizuel</b> - Ndhmon që fëmija të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).</li> <li><b>Nxitja dhe zhvillimi i shkathtësive matematikore</b></li> </ol>									
<b>Vazhdo vargun:</b>									
									
									
									
<b>Shembull për punë individuale</b>									
Para fëmijës vendosen vargje të figurave me ngjyra. Ai pyetet për emrin e figurës, ngjyrën, vendosjen. Fillohet vargu dhe kërkohet nga fëmija që ta vazhdon vargun me kartelat e tjera.									



Aktiviteti 2

LIDHSHMËRIA

**Përshkrimi** Kartela – rradhitëse

**Fusha për intervenime**

- 1 **Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë.
2. **Perceptimi vizuel** -. Ndhmon që fëmija të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).
3. **Motorika** – aritje e fleksibilitetit dhe gjendshmërisë të shputës dhe gishtërinjëve dhe koordinimit sy-dorë



**Shembull për punë individuale**

- Vendosja e formave në vend përkatës
- Caktimi i figurave në hapësirë (majtas – djathtas, mbi – nën, para - pas)



## Aktiviteti 3

KËRKIMI I DALLIMEVE		
<b>Përshkrimi</b> Fleta pune me fotografi ose vargje me numra, shkronja, gjësende		
<b>Fusha për intervenime</b>		
1. <b>Koncentrimi dhe vëmendja</b> – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë fokusimi i pjesëve dhe elementeve		
<b>Shembull për punë individuale</b>		
Në fletë të punës janë dhënë çifte të vargjeve nga numrat dhe shkronjat. Fëmija duhet të vëren se te cili çift ka dallime dhe në çka dallohen.	123467589 123457689 589630094 589630094 869383896 869833986	ASMNRTOLP AXMHRTOPL RXIKBDJFZ RXIKPDJFS HBUVOIJBHN HBUVOIJBHN

## Aktiviteti 4

RRADHITJA E FIGURAVE SIPAS RRADHËS	
<b>Përshkrimi</b> Kartelat e ilustruara (ose sllajdet) me koncepte/gjësende të cilat janë me përbërje të ndryshme të rrokjeve.	
<b>Fusha për intervenime</b>	
1. <b>Koncentrimi dhe vëmendja</b> – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe të fokusohet nga ajo se çka kërkohet nga ai.	
2. <b>Pasurimi i fjalorit dhe të shprehurit verbal.</b>	
3. <b>Perceptimi vizuel</b> -. Ndhmon që fëmija të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).	
<b>Shembull për punë individuale</b>	
Kartlat ose sllajdet i tregohen fëmijës gjatë së cilës të njejtat shpejtë ndërrohen. Nga fëmija kërkohet që të regon se çka shikon në secilën nga ta. Shënohet se çka fëmija shikon dhe si e shqipton ate. Pastaj nga ai kërkohet që të bën lidhjen e një ose më tepër ilustrimeve me disa nga asociacionet e veta, të cilat pastaj mundet ti zhvillon në fjali, me çka gradualisht pasurohet edhe fjalori.	

## Aktiviteti 5

## TË RRADHITURIT E RRADHITËSVE

**Përshkrimi** Rradhitësi me nivel të ndryshëm të peshës

**Fusha për intervenime**

1. **Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe të fokusohet nga ajo se çka kërkohet nga ai
2. **Funksionimi kognitiv** – lidhja e pjesëve në tërësi, lidhja e numrit me sasinë, lidhja e shkronjës me fotografinë
3. **Perceptimi vizuel** -. Ndhmon që fëmija të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore)..

**Shembull për punë individuale**

Rradhitësit jepen gjatë takimeve të para me qëllim që në mënyrë më të suksesshme të realizohet kontakti me fëmijën. Në fillim jepen rradhitës më të thejshëm me qëllim që fëmija të përjeton sukses. Deri sa ai punon bisedohet për ngjyrën e elementeve, vendosjen e tyre, për vetë vizatimin, për atë se çka tregon secili element, etj. Gjatë punës së mëturjeshe shfrytëzohen rradhitës më të ndërlikuar nëpërmjet të cilëve, përveç se ushtrohet në koncentrim, nxiten edhe proceset më të larta mendore.



## Aktivite tjera dhe materiale për zhvillimin e koncentrimit dhe vëmendjes

- ▶ Labirinthe
- ▶ Vizatime me ngjyra
- ▶ Gjetja e personave të fshehur, gjësendeve, kafshëve dhe të tjera në fotografi
- ▶ Gjetja e gabimeve në shembujt të cilët përsëritent

### 3.3. Perceptimi dhe të mbajturit mend

**Perceptimet** paraqesin procese psiqike të njohjes së gjësendeve dhe dukurive në tërësi. Vështirësi më të shpeshta të cilat mund të paraqiten te fëmijët janë në mënyrat se si pranohen informatat nëpërmjet të shqisave, por edhe në mënyrat se si shprehen informatat e pranuar, të cilat janë në realitet edhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen fëmijët me disleksi, disgrafi dhe diskalkuli.

Tek perceptimi vizuelo – hapësinor vështirësi paraqitet në fushën e diskriminimit të formave sipas pamjes, pozitës dhe kahjes, perceptim i figurës dhe prapavisë, të vërejturit dhe ndarja e gjërave me rëndësi gjatë shikimit të dukurive, përcjelljes së fjalëve gjatë shkrimit dhe leximit, gjendshmëria në reshtat në teksitë e dhënë, ndërimi i vendeve të tingujve, rrotullimi i fjalëve, si dhe gjatë teknikës së të shkruarit.

Tek perceptimi dëgjues vështirësi më së shpeshti paraqiten gjatë të dëgjuarit të koncentruar, dallimi dhe të mbajturit mend i zërave, fjalëve dhe tërësive folëse, ndjekja e saktë dhe të mbajturit mend e informatës që dëgjohej, të kuptuarit jo të plotë të asaj që dëgjohej, saktësia e riprodhimit folës, analiza e fjalëve dhe fjalive, të shkruarit e diktimit gjatë së cilës paraqiten lëshime të shkronjave gjatë të shkruarit.

**Të mbajturit mend** paraqet aftësi të përvetësimit, të mbajtjes dhe shfrytëzimit të informatave të cilat i kemi përvetësuar nëpërmjet të përvojës ose të mësuarit aktiv. Aftësia për të mbajtur mend është kusht i nevojshëm për të gjitha proceset tona kognitive – të menduarit, sjellja e përfundimit, njohja, mësimxënia, të folurit.

Ekzistojnë tre faza të të mbajturit mend nëpër të cilat kalon informata, prandaj mundemi të flasim për të mbajturit mend sensorik, afatshkurtër dhe afatgjatë.

Të mbajturit mend sensorik (perceptiv) do të thotë që shumë shkurtë mbahet mend informata në formë të pandryshuar, pa qëllimin tonë që ajo të ndodh. Për fushën vizuale koha e të mbajturit mend paraqet përafërsisht gjysmë sekonde, a për fushën dëgjuese afër dy sekonda.

Pasi që një porosi është inçizuar shkurtimisht nëpërmjet të të mbajturit mend sensorik, vijon të menduarit afatshkurtë, nëpërmjet të së cilës nga përsëritja mund të mbahen mend aq informata sa që kemi nevojë ne. Këtu porositë ndryshojnë (kodojnë) me çka bëhen të kuptimta për personin dhe në atë mënyrë që do të mundën përsëri të gjenden.

Të menduarit afatgjatë ka kapacitet të pakufizuar. Te ai vendosen informatat nga të mbajturit mend afatshkurtë dhe sipas disa autorëve aty mbeten tërë jetën.

Vështirësitë te fëmijët më së shpeshti paraqiten gjatë të mbajturit mend të të dhënave të dëguara, të shikuara ose të lexuara në raport me rrjedhën e tyre, lidhshmërinë dhe numrin, si dhe në raport të qëndrueshmërisë së të dhënave të pjesërishtme dhe jo të lidhura, që sjell deri në vështirësi gjatë interpretimit, shpjegimit ose të përgjigjurit e pyetjeve.

## Shembuj të aktiviteteve dhe materialeve për përkrahje individuale

### Perceptimi

#### Aktiviteti 1

##### TË VËREJTURIT E NGJASHMËRIVE DHE DALLIMEVE

**Përshkrimi** Çifte të fotografive me dallime në disa elemente në raport me ngjyrën, formën, prezencën, mungesën ose vendosjen

##### Fusha për intervenime

- 1. Perceptimi vizuel** -. Ndhmon që fëmija të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).
- 2. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe të fokusohet nga ajo se çka kërkohet nga ai



##### Shembull për punë individuale

Para fëmijës vendosen kartelat me çifte të fotografive. Ai nxitet:

1. Ti gjen dallimet:
2. Ti tregon dallimet në fotografi
3. Të tregon se në çka përbëhet secili dallim (ngjyra, ka – ska element, forma, madhësia ...)

## Aktiviteti 2

## GJETJA E PJESËVE NGA TË CILAT ËSHTË FORMUAR FIGURA


**Përshkrimi** Format e drurit me madhësi të ndryshme, forma, ngjyra dhe skema të fotografive të formuara nga elementet përkatëse të formave të drurit.

## Fusha për intervenime

- 1. Perceptimi vizuel** - Ndhmon që fëmija të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore).
- 2. Koordinimi sy – dorë** – kontrollim i koordinuar i lëvizjeve të syve me lëvizjet e dorës
- 3. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.

## Shembull për punë individuale

Fëmija duhet ti vendos në pjesët e skemës format përkatëse të drurit. Gjatë kësaj bisedohet për ngjyrën formën, madhësinë vendosjen e elementeve.



## Aktiviteti 3

## FORMIMI I FORMAVE TË NDRYSHME NGA PJESË TË NJEJTA


**Përshkrimi** Kartela me pjesë nga fotografia. Pjesët janë me madhësi të njëjta.

## Fusha për intervenime

- 1. Perceptimi vizuel** - Ndhmon që fëmija të kuptojë se çka shikon, të njeh dhe kupton elemente të ndryshme (madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore)
- 2. Koordinimi sy – dorë** – kontrollim i koordinuar i lëvizjeve të syve me lëvizjet e dorës.
- 3. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.

## Shembull për punë individuale

Nga fëmija kërkohet të formon fotografi të ndryshme nga pjesët e dhëna të njëjta. Fillohet me numër më të vogël të pjesëve dhe pastaj e njeta zmadhohet pas disa tentimeve të suksesshme.




## Aktiviteti 4

## TË DALLUARIT E FIGURAVE SIPAS FORMËS, NGJYRËS DHE POZITËS NË HAPËSIRË

**Përshkrimi** -Kartela me pamje dhe forma të ndryshme të vendosura në prapavijë me ngjyrë të ndryshme.  
-Forma të ndryshme gjeometrike nga druri, plastika ose kartuçi, me madhësi dhe ngjyrë të ndryshme.

**Fusha për intervenime**

- 1. Perceptimi vizuel** – zhvillimi i perceptimit për pamje dhe prapavijë  
**Perceptimi taktil** – njohja e gjëseneve dhe sipërfaqeve me preken.
- 2. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjëseneve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.
- 3. Nxitja dhe zhvillimi i shkathtësive matematikore**

**Shembuj për punë individuale**

Para fëmijës vendosen kartela me figura dhe forma të ndryshme të vendosura në prapavijë me ngjyrë të ndryshme. Pyetet për emrin e figurës ose formës së kartelës, ngjyrës së formës dhe ngjyrës së prapavijës. Fillohet vargu dhe kërkohet nga fëmija ta vazhdon vargun me kartelat tjera.

Para fëmijës vendosen figura të ndryshme gjeometrike. Në takimet e ndryshme ushtrohen:

1. Grupimi i formave
2. Formimi i vargjeve nga format
3. Krahasimi i formave sipas madhësisë, ngjyrës, formës
4. Caktimi i raporteve ndërmjet formave (më e madhe – më e vogël).
5. Njohja e formave të ndryshme me prekje, gjatë së cilës sytë janë të mbyllur

## Aktiviteti 5

## TË DALLUARIT E MATERIALEVE NËPËRMJET PREKJES

**Përshkrimi** -Strajcë me fara të ndryshme – groshë, oriz, makarona,...

**Fusha për intervenime**

- 1. Perceptimi taktil** – njohja e gjëseneve dhe sipërfaqeve me prekje.
- 2. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë.
- 3. Zhvillimi i motorikës së vogël**

**Shembull për punë individuale**

Para fëmijës vendosen strajca të mbyllura me materiale të ndryshme. Fëmija duhet që nëpërmjet të prekjes të njeh përmbajtjen e strajcës, mund të kërkohet nga ai që pastaj që ti numëron kokrrat, të grupojë të tregojn karakteristika të asaj se çka është në strajcë, etj.



## Aktiviteti 6

### PUNË ME SHKOPINJ ME NGJYRA

**Përshkrimi** -Shkopinj me ngjyra të ndryshme, me trashësi të ndryshme dhe me gjatësi të ndryshme

#### Fusha për intervenime

- 1. Perceptimi vizuel** – njohja e ngjyrave, gjatësia dhe gjërësia, raportet hapësinore
- 2. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi të fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë.
- 3. Nxitja dhe zhvillimi i aftësive kognitive dhe matematikore** (vargjet, grupimi, numërimi, mbledhja, zbritja, lidhja e sasisë me numër)
- 4. Zhvillimi i motorikës së vogël dhe koordinimi sy – dorë**



#### Shembull për punë individuale

Para fëmijës vendosen shkopinj dhe nga ai mund të kërkohet:

- ti rradhit në vargje
- ti rradhit sipas ngjyrës
- ti grupon sipas ngjyrës dhe numrit
- të vazhdojë vargun e dhënë
- të numërojë
- të bëjë lidhshmërinë e sasisë së caktuar me numër të dhënë të kartelës ose të pllakës
- të mbledh
- të zbret

## Aktivitete tjera që kanë të bëjnë në zhvillimin e aftësive perceptive

PERCEPTIMI VIZUELO-HAPËSINOR, ORIENTIMI NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	PERCEPTIMI TAKTIL	PERCEPTIMI I DËGJIMIT
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ushtrime për përvetësimin e lateralizimit të trupit vetanak</li> <li>2. Ushtrime për orientim dhe përjetim në hapësirë (drejtim, përjetimi i trupit vetanak në hapësirë)</li> <li>3. Ushtrime për orientim dhe përjetim të kohës (sa kohë zgjat, njëkohësisht, rradhitja, ritmi, përputhja në kohë, njëtrajtësisht)</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ushtrime – prekje e gishtit, ndërsa fëmija qëllon me sy të mbyllur se kush është</li> <li>2. Njohja e gjësëndeve dhe sipërfaqeve me prekje, bashkimi me fotografi dhe anasjelltas</li> <li>3. Njohja e shkronjave, fytyrave, numrave të shënuar në dorë</li> <li>4. „Të shënuarit” e shkronjave, numrave, formave, me gisht në shpinë, ndërsa fëmija qëllon.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përsëritja e asaj që dëgjohet</li> <li>2. Argumentimi perceptiv fotografi – fjalë</li> <li>3. Shqiptimi i zërit me zmadhim dhe zvogëlim të njëtrajtshëm të zërit gjatë theksimit, derisa fëmija nuk e njeh zërin.</li> </ol>

## Të mbajturit mend

### Aktiviteti 1

#### TË MBAJTURIT MEND E RRADHITJES SË GJËSENDEVE OSE FOTOGRAFIVE

**Përshkrimi** -Kartela memoruese – kartela me fotografi nga gjësende të ndryshme, bimë, kafshë, numra, etj. -gjësende të ndryshme

#### Fusha për intervenime

- 1. Perceptimi vizuel dhe të mbajturit mend** – mundësia për interpretimin e informatave të pranuar nëpërmjet syrit. Ndihmon që fëmija të kuptojë çka shikon, gjegjësisht të njeh dhe të kuptojë elemente të ndryshme, siç janë madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore dhe të njejtat ti mban mend sipas rradhës.
- 2. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm



#### Shembuj për punë individuale

**“Përsërit se çka vërejte”**- Fëmijës i tregohet kartelë memoruese me nëntë fotografi. Fëmija duhet ta shikojë, pastaj kartela kthehet mbrapsht ose hiqet anash, ndërsa fëmija duhet të tregojë aq fotografi sa që ka mundur të mbajë mend sipas rradhitjes së tyre.

Koha e të shikuarit të kartelës në fillim mundet të jetë më e gjatë, ndërsa me kalimin e ushtrimit koha shkurtohet. Në fillim fëmija nuk është e thënë që fotografitë ti përsërisë sipas rradhitjes, por vetëm të tregon se çka ka parë, ndërsa me kalimin e ushtrimit kërkohet që të përsëriten sipas rradhitjes.

**“Qëlllo çka mungon”** – fëmijës i tregohet një varg nga 8 - 10 gjësende ose fotografi , fshehën disa, ndërsa fëmija duhet të qëllon se çka mungon.

Ushtrimi zhvillohet në atë mënyrë që nga nxënësi kërkohet, që përveç se ti shikon elementet të cilat duhet ti mban mend, të njejtat edhe ti emëron. Në këtë mënyrë:

- fitojmë informata se a din nxënësi ta emëron elementin të cilin shikon, për shkak se gjatë reprodukimit mund të ndodh që i njejt mos e tregon për shkak se nuk e din se çka paraqet, gjegjësisht nuk e din ta emëron;
- njëkohësisht e ushtrojmë edhe të folurit;
- arrijmë përforcimin e asaj që është perceptuar, a duhet të mbahet mend në atë mënyrë që informatën e pranon në të njejtën kohë në më shumë mënyra
- nëpërmjet syve, veshëve (kur dëgjon vetëveten) dhe me ndihmën e të folurit.




## Aktiviteti 2

## HARTAT E TË MENDUARIT

**Përshkrimi** Letër, ngjyra

**Fusha për intervenime**

- 1. Funksionimi kognitiv** – të mbajturit mend të informatave dhe organizimi i tyre në bazat e të dhënave. Paraqitja grafike e të dhënave. Bërja e koncepteve duke bërë lidhshmërinë e informatave nëpërmjet të asociacioneve dhe gjetja e relacioneve logjike.
- 2. Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.



**Shembuj për punë individuale**

- Formimi i hartave mendore për të mbajtur mend të punëve dhe gjësendeve të përditëshme.
- Formimi i hartave mendore për material mësimor të cilën fëmija duhet ta mësojë.
- Ky aktivitet është me rëndësi të veçantë kur punohet me nxënës me vështirësi të përgjithëshme në mësimnxënie, gjegjësisht kur punohet në fushën e organizimit dhe teknikave mësimore

## Aktiviteti 3

## MBAJTJA MEND E VARGJEVE ME NDIHMËN E FOTOGRAFIVE

## Përshkrimi Fotografitë

## Fusha për intervenime

1. **Perceptimi vizuel dhe të mbajturit mend.** Ndhmon që fëmija të mban mend vargjet me rima dhe ritëm dhe të bën lidhshmëri me fotografitë e dhëna.
2. **Zhvillimi i të folurit dhe shprehurit verbal.** Ndhmon në nxitjen dhe zhvillimin e të folurit te fëmija nëpërmjet vargjeve. Përmirësohet të shprehurit verbal te fëmija nëpërmjet vargjeve interesante
3. **Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.



## Shembuj për punë individuale

Fëmijës i tregohet fotografia, i tregohen vargjet njëra pas tjetrës, ndërsa fëmija duhet ti përsërisë. Shembull: Kur punohet me strofën e parë tregohet fotografia e parë me qenin, kur punohet me strofën e dytë tregohet fotografia me macën dhe në strofën e tretë fotografia me peshkun. Në secilën fotografi është shkruar emri i kafshës konkrete.

## Ushtrime tjera të cilat kanë të bëjnë me nxitjen e të mbajturit mend

- ▶ Përsëritja e vargjeve verbale të njohura dhe të panjohura
- ▶ Përsëritja e vargjeve të numrave
- ▶ Zgjerimi i fjalive
- ▶ Shfrytëzimi i asociacioneve mnemo – teknike dhe lidhshmëria.

### 3.4. Motorika

Aftësitë motorike paraqesin përmbledhje të lëvizjeve të koordinuara të trupit të njeriut me të cilat udhëheq truri.

Te këta shkathtësi dallojmë motorikën e madhe dhe të vogël.

**Motorika e madhe** nënkupton aftësi përrealizmin e lëvizjeve të duarve, këmbëve ose trupit me kontrollim të caktuar.

**Motorika e vogël (e imtë)** është aftësi që të bëhen lëvizje të vogla (imëta) precize me duar me të mbajturit e koordinimit të mirë ndërmjet gishtave dhe syve. Me përvetësimin e suksesshëm të procesit së të shkruarit të cilën fëmija e pret në shkollë, është e nevojshme që në fillim të zhvillohet motorika e vogël e muskujve të pëllëmbës së dorës dhe gishtërinjëve. Motorika e vogël përfshinë edhe grafomotorikën kualiteti i të cilës është shumë me rëndësi gjatë shkuarjes së fëmijës në shkollë, veçanërisht në pjesën e zhvillimit të fleksibilitetit të pëllëmbës dhe gishtërinjëve. Grafomotorika në realitet ushtrohet edhe gjatë realizmit të aktiviteteve të ndryshme të përditëshme siç janë: të mbajturit e kubeve dhe zhvendosja nga dora në dorë, lidhja e penjëve të këpucëve ose atleteve, mbledhja e gjësendeve të imëta, rradhitja e shkopinjëve, vendosja e monedhave në arkë, shfletimi i fletëve të librit, etj. Me këta aktivitete nxitet përforcimi i pëllëmbës, gjendshmëria e saj, si dhe zhvillimi i koordinimit sy – dorë, perceptimi dhe koncentrimi.

#### Riedukimi psikomotorik

Qëllimi i riedukimit psikomotorik është që te fëmija të rinovohen dhe pasurohen përvojat jetësore për hapësirë, kohë, për vete dhe për njerëzit e tjerë rreth tij. Ushtrimet për riedukimin psikomotorik janë pjesë e punës defektologje dhe këtu do ti përmendim vetëm një pjesë të tyre me qëllim ti tregojmë efektet nga zbatimi i tyre:

1. Ushtrime për përjetimin e tërësisë trupore.
2. Ushtrime për arritjen e pavarësisë, koordinimin, ritmikën e lëvizjeve, ushtrime për kontrollimin e motorikës, ushtrime për përmirësimin e grafomotorikës dhe arritjen e njëtrajtshmërisë të tonit.
3. Ushtrime për vështrim, stabilizim dhe orientim të lateralizimit vetanak dhe te të tjerët.
4. Ushtrime për vëzhgimin dhe përjetimin e hapësirës gestulative, (hapësirës që zgjat ndërmjet trupit dhe deri te ekstremitetet e zgjatura, gjegjësisht trupi vetanak në hapësirë).
5. Ushtrime për orientim në hapësirën objektive, gjegjësisht në hapësirën e cila është jashtë fushës së lëvizjes së ekstremiteteve.
6. Ushtrime për përjetimin e (kohës sa kohë zgjat, njëkohësisht, rradhitja, ritmi, përputhja në kohë, njëtrajtësisht).
7. Ushtrime përpërjetime funksioneve njohëse (klasifikimi, konzervimi, vargëzimi, korenspondimi).

## Shembuj të aktiviteteve dhe materialeve për përkrahje inividuale

### Grafomotorika

#### Aktiviteti 1

##### FORMIMI I FIGURAVE NGA PJESËT

###### Përshkrimi Rradhitësit



###### Fusha për intervenime

1. **Motorika** – arritja e fleksibilitetit dhe shkathtësisë së pëllëmbës dhe gishtave si dhe koordinimi sy – dorë
2. **Perceptimi vizuel** – ndihmon që fëmija të kuptojë çka shikon, gjegjësisht të njohë dhe kuptojë elementet e ndryshme, siç janë madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore.
3. **Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjëseneve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.
4. **Funksionet kognitive** – vështrimi, kombinimi dhe sintetizimi në tërësi nga pjesët (analiza dhe sinteza)



Përveç rradhitësve të gatshëm mund të punohen edhe rradhitës si p.sh. nga pjesët e trupit, fytyra, automjete, skena nga aktivitetet fëmimore, etj. Gjatë formimit të fotografive bisedohet për vetë fotografinë dhe bëhet lidhshmëria nga përjetimet e fëmijës.



## Aktiviteti 2

<b>VENDOSJA E FIGURAVE OSE SHKRONJAVE NË VARG</b>	
<b>Përshkrimi</b> Rradhitësit	
<b>Fusha për intervenime</b>	
<p><b>1. Motorika</b> – arritja e fleksibilitetit dhe shkathtësisë së pëllëmbës dhe gishtave si dhe koordinimi sy – dorë</p> <p><b>2. Perceptimi vizuel</b> – ndihmon që fëmija të kuptojë çka shikon, gjegjësisht të njohë dhe kuptojë elementet e ndryshme, siç janë madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore.</p> <p><b>Perceptimi taktil</b> – njohja e gjësendeve dhe sipërfaqeve me prekje.</p> <p><b>3. Koncentrimi dhe vëmendja</b> – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë.</p>	
	
<b>Shembull për punë individuale</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosja e formave në vendin përkatës</li> <li>- Formimi i vargjeve sipas ngjyrës gjatë vendosjes së formave</li> <li>- Emërimi i formave dhe ngjyrave</li> <li>- Caktimi i figurave në hapësirë (ajtas – djathtas, nën – mbi, para - pas)</li> </ul>	

## Aktiviteti 3

<b>TETËSHJA E SHTRIRË</b>	
<b>Përshkrimi</b> Ushtrime për gjimnastikën e trurit – brain gym	
<b>Fusha për intervenime</b>	
<p><b>1. Motorika</b> – arritja e fleksibilitetit dhe shkathtësisë së pëllëmbës dhe gishtave si dhe koordinimi sy – dorë, lateralizimi dhe nxitja e të dy hemisferave trurorë</p> <p><b>2. Koncentrimi dhe vëmendja</b> - Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.</p>	
<b>Shembull për punë individuale</b>	
<p>Në ajër ose në letër me duar të shtrira vizatohet tetëshja e shtrirë. Përseriten lëvizjet pesë herë me dorën e djathtë pesë herë e dorën e majtë dhe pesë herë me të dy duart.</p> <p>Me të dy duart njëkohësisht vizatohen spirale ose rathë koncentrik.</p>	
	

## Aktiviteti 4

## RRADHITJA E FIGURAVE, FORMIMI

**Përshkrimi** Figura nga druri dhe plastika

**Fusha për intervenime**

1. **Motorika** – arritja e fleksibilitetit dhe shkathtësisë së pëllëmbës dhe gishtave si dhe koordinimi sy – dorë
2. **Perceptimi vizuel** – ndihmon që fëmija të kuptojë çka shikon, gjegjësisht të njohë dhe kuptojë elementet e ndryshme, siç janë madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore.
- Perceptimi taktil** – njohja e gjësendeve dhe sipërfaqeve me prekje..
3. **Koncentrimi dhe vëmendja** – Zhvillimi te fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.



**Shembull për punë individuale**

- Rradhitja e figurave sipas ngjyrës, njohja e ngjyrave
- Rradhitja e figurave sipas madhësisë, krahasimi më i madh më i vogël
- Caktimi i figurave në hapësirë (majtas – djathtas, nën – mbi, para - pas)
- Formimi i fotografise, gjësende

## Aktiviteti 5

## FORMIMI I FIGURAVE – MOZAIK NGA SHPUSET

## Përshkrimi Shpuese – mozaik

## Fusha për intervenime

1. **Motorika e vogël** - arritja e fleksibilitetit dhe shkathhtësisë së pëllëmbës dhe gishtave. Kontrollimi i koordinuar i lëvizjeve të syve me lëvizjen e pëllëmbës dhe gishtave.
2. **Perceptimi vizuel** - ndihmon që fëmija të kuptojë çka shikon, gjegjësisht të njohë dhe kuptojë elementet e ndryshme, siç janë madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore.
3. **Koncentrimi dhe vëmendja** - Zhvillimi të fëmija i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orienton nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.
4. **Funksionet kognitive** - fëmija vëren, kombinon dhe sintetizon tërësi nga pjesët e vogla (analizë dhe sintezë). Gjithashtu nxit kreativitet dhe motivim të fëmija.



## Shembull për punë individuale

- Shpuarja e elementeve në bazë – zhvillimi i aftësive të gishtave
- Rradhitja e figurave sipas ngjyrës, njohja e ngjyrave
- Caktimi i figurave në hapësirë (majtas – djathtas, nën – mbi, para - pas)
- Formimi i fotografive

## Aktiviteti 6

## TAKTILOGRAFIA

## Përshkrimi Plastelinë,

## Fusha për intervenime

**1. Motorika** – arritja e fleksibilitetit dhe shkathtësisë së pëllëmbës dhe gishtave si dhe koordinimi sy – dorë.

**2. Perceptimi vizuel** – ndihmon që fëmija të kuptojë çka shikon, gjegjësisht të njohë dhe kuptojë elementet e ndryshme, siç janë madhësia, ngjyra, forma, raportet hapësinore.


**Perceptimi taktil** – njohja e gjësendeve dhe sipërfaqeve me prekje.

**3. Nxitja e aftësive gjuhësore** – ndihmon fëmijën të mundet ti kuptojë fjalët, të mendon për ta, të mësojë për kontekstet e ndryshme në të cilat mund të paraqiten, ndihmon që të njejtat që të mbahen mend më gjatë edhe atë në të tre format që paraqiten – si zë, si vargje të shkronjave dhe formave dhe rëndësia e tyre, me çka të njejtat mund të deshifrohen më lehtë dhe më shpejt në tekstin e dhënë. Ky është aktivitet i shkëlqyeshë për të filluar procesin e arsimimit të fëmijëve me disleksi.

**4. Koncentrimi dhe vëmendja** - Zhvillimi i fëmijës i aftësisë që vëmendjen që në periudhë më të gjatë kohore pa ndërprerje ta orientojë nga një detyrë dhe nga ata veti të gjësendeve, dukurive dhe personave të cilat janë të rëndësishëm.

## Shembull për punë individuale

1. Fëmijës i tregohet ndonjë gjësend
2. Kërkohet që ta emëron me zë
3. E formon emrin e gjësendit nga kartelat e ofruara me shkronja
4. E shkruan të njejtën me ndihmën e plastelinës – modelon shkronjat
5. Pasi që të përfundon e prek secilën shkronjë dhe e thotë.





## Aktivitete tjera të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e motorikës

- ▶ Ushtrime për lëvizjen e duarve
- ▶ Palosja e teshave, lidhja e këpucëve, vendosja e monedhave në arkë, rradhitja e ruazave
- ▶ Rradhitja e fjalëve dhe fjalive nga shkronjat dhe fjalët e prera
- ▶ Vizatimi i figurave, shënimi i shkronjave, fjalëve, fjalive
- ▶ Të vizatuarit
- ▶ Ndërtimi i figurave nga shkopinjtë
- ▶ „Të shkruarit“ në miell, oriz, thjerëza, etj.
- ▶ Zënia e brumit ose plastëlinës
- ▶ Mbajtja e lodrës në dorë ose tophitit me thera
- ▶ Të shkruarit me mbajtjen e letrës në pëllëmbë (për ushtrim të mbajtjes si duhet të dorës gjatë të shkruarit)
- ▶ Loja “Dama” (kërcimi nëpër fushat e shënuar me një ose dy këmbë sipas rradhitjes së caktuar)



### 3.5. Aktivitete tjera për nxitjen dhe zhvillimin e të folurit, aftësive gjuhësore dhe matematikore

Vlerësimi diagsnotik për gatshmërinë për lexim paraqet vështirim për shkallën e zhvillimit të shkathtësive para lexuese të fëmija dhe mund të shfrytëzohet në klasën e parë dhe në fillim të klasës së dytë. Ajo jep dukshëm indikacione të mira për përparimin dhe shpejtësinë e arsimimit të fëmijës, ndërsa për bashkëpunëtorët profesional paraqet kahje për ate se ku duhet të intervenohet. Është e formuar nga 6 elemente – 6 shkathtësi para lexuese:

- Identifikimi i tingullit të parë të fjalës
- Identifikimi i tingullit të fundit të fjalës
- Analiza e tingujve në fjalë (nga sa shkronja – tinguj është formuar fjala “MUZIKA”?)
- Sintezë e tingujve në fjalë (cilën fjalë e thash? K – Ë – N – G – A)
- Identifikimi i rimës (themi vargje me rima, pastaj kërkojmë që të shtojë fjalë tjera të cilat përputhen – me kuptim ose pa kuptim)
- Identifikimi dhe segmentimi i rrokjeve (themi fjalë me duartrokite aq sa ka rrokje, pastaj kërkojmë që ta përsërisë ate me fjalë tjera, të duartroket dhe të ndajë në rrokje, të tregon se sa rrokje ka)

Në rast se një ose më tepër shkathtësi mungojnë ose janë më pak të zhvilluara, janë të mundëshme vështirësi gjatë arsimimit, ndërsa ushtrimi intenziv i të njetës don të thotë se fëmija më lehtë do të arsimohet.

#### NXITJA DHE ZHVILLIMI I TË FOLURIT

##### Zhvillimi i analizës dhe sintezës së zërit

- ▶ Gjetja e fotografisë së gjësendit emri të cilit fillon me shkronjë të caktuar
- ▶ Gjetja e fotografisë së gjësendit emri të cilit mbaron me shkronjë të caktuar
- ▶ Gjetja e fotografisë së gjësendit emri të cilit ekziston me shkronjë të caktuar
- ▶ Shqiptimi shkronjë pas shkronje në fjalë – sintezë
- ▶ Shqiptimi i ndonjë fjale të dhënë shkronjë pas shkronje – analiza
- ▶ Ndarja e grupeve të gjësendeve të cilat fillojnë me shkronjat B/T, B/P, D/T; Z/S
- ▶ Ndëgjimi i tregimit dhe njohja e fjalës që fillon me ndonjë shkronjë të caktuar
- ▶ Numërimi i pjesëve nga ndonjë tregim dhe rradhitja në varg të rregullt;
- ▶ Leximi i pjesëve nga ndonjë tregim me repsektim të shenjave interpuktive dhe pazave intonative, shpjegimi i tregimit).
- ▶ Njohja e fjalëve të cilat janë lexuar mbrapsht.
- ▶ Formimi i fjalëve nga shkronjat e përziera
- ▶ Ndërimi i shkronjave të caktuara me të tjera në fillim të fjalës, a nuk ndryshon rrokja e fundit për tu ruajtur zërimi i fjalës (ndjenja për rimë)



**NXITJA DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE**

- ▶ Ndarja e fjalëve në rrokje dhe formimi i fjalëve nga rrokjet
- ▶ Shpjegimi sipas vargjeve në fotografi
- ▶ Leximi me kuptim
- ▶ Përshkrimi i ndonjë fytyre, fotografie ose gjësendi
- ▶ Plotësimi i fjalive me fjalë
- ▶ Formimi i pavarur i fjalive të thjeshta.
- ▶ Fjalë e dhënë në fillim, të përfundohet me fjali
- ▶ Titulli i dhënë (fjali provokuese) - të formohet tregim
- ▶ Shpjegimi në pjesë: në fillim, pastaj, në fund.

**NXITJA DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE MATEMATIKORE**

- ▶ Grupimi dhe formimi i vargjeve të gjësendeve dhe formave
- ▶ Krahasimi i gjësendeve dhe formave
- ▶ Formimi i koncepteve për numër - lidhshmëria me fotografi - numër
- ▶ Numërimi
- ▶ Caktimi i vendit të numrit në varg
- ▶ Caktimi i raportit ndërmjet gjësendve (më i madh - më i vogël)
- ▶ Përvetësimi i operacioneve themelore matematikore "kapëse me numra dhe shenja, "Dama",



## Literatura dhe burimet

1. Abazović J., Igrom do inkluzije, priručnik za nastavnike osnovnih škola, UNICEF, INFOHOUSE, Sarajevo 2015.
2. Bjelica J., Galić-Jušić I., Pavlić-Cottiero A., Posokhova I., Prvčić I., Rister M., Priručnik o disleksiji, disgrafiji i sličnim teškoćama u čitanju, pisanju i učenju, Zagreb 2005.
3. Branstetter R., The school psychologists survival guide, School psychologists-United States of America – Handbooks – manuals, 2012.
4. Embracing diversity: Toolkit for Creating Inclusive, Learning-Friendly Environments, UNESCO, Thailand, 2005.
5. Hrnjica S., Mitić M., Piper B., Radojević B., Rajović V., Stefanović M., Veljković L., Žegarac N., Radović-Župunski M., Deca sa smetnjama u razvoju – potrebe i podrška, FAMILIA, Beograd 2011.  
[http://www.familia.org.rs/deca\\_sa\\_smetnjama\\_u\\_razvoju.pdf](http://www.familia.org.rs/deca_sa_smetnjama_u_razvoju.pdf)
6. Igrom do škole: priručnik za voditelje igraonica s djecom iz socijalno-depriviranih sredina – iskustva iz prakse, pripremila M. Markočić, Udruženje Djeca prva, Zagreb 2004.
7. Jovanović V., Petrović D., Milivojević Z., Jeremić J., Lažetić P., Obrazovna inkluzija dece romske nacionalnosti, Centar za obrazovne politike, Beograd 2013.
8. Mastropieri M., Scruggs T., The inclusive classroom – strategies for effective differentiated instruction, Pearson education, New Jersey 2013.
9. Prvčić I., Rister M., Deficit pažnje/hiperaktivni poremećaj (ADHD/ADD), Ministarstvo znanosti, obrazovanja i športa, Agencija za odgoj i obrazovanje, Zagreb 2009.
10. Supporting Students with Learning Disabilities, A Guide for Teachers, Ministry of Education and the British Columbia School Superintendent’s Association, 2011.
11. Škola PUNa mogućnosti, Program uvođenja pomoćnika u nastavi, Europska unija, Europski strukturni i investicijski fondovi, ESF, Zadar 2016.
12. Thomson M. E., E. J. Watkins, Dyslexia, A Teaching Handbook, Whurr Publishers, London 2000.
13. Weidinger W., Improve your self-esteem and work together – ages 10–12, Zurich University of Teacher Education, Centre IPE, 2015.
14. [http://marul.ffst.hr/~batarelo/PPDMO/posebnepotrebe/predavanja/PPP\\_Ilidio.pdf](http://marul.ffst.hr/~batarelo/PPDMO/posebnepotrebe/predavanja/PPP_Ilidio.pdf)  
(Batarelo Kokić, Ivana, Pedagogija djece s posebnim potrebama)
15. <http://www.inkluzija.org/biblioteka/Bodriti%20dobre%20ili%20dobriti%20bodre.pdf>
16. [www.logopedi.rs](http://www.logopedi.rs) – Vežbe koncentracije